



ARISTIDH P. KOLA

ARVANITASIT  
DHE PREJARDHJA E GREKËVE

*Vështrim Historik - Folklorik - Politik - Gjuhësor*

përktheu nga origjinali:  
Aldior Agora



*ARVANITASIT  
DHE PREJARDHJA E GREKËVE*

## PASQYRA E LËNDËS

Një libër që duhej botuar më parë .....	13
PARATHËNIE .....	22
HYRJE .....	29

## PJESA E PARË KAPITULLI I PARË

Pellazgët .....	35
Lidhjet e Pellazgëve me fiset e njoitura helene .....	48
Etimologjia * e emrit kombëtar “Pellazg” .....	50
Lelejet - Karet - etj. .....	52
Ilirët - Helenët .....	55
Lidhjet e Biotëve dhe Tebëve me Ilirët .....	58

## KAPITULLI I DYTË

Kadmi .....	62
a) Përdorimi i shkronjave .....	63
b) Sfinksi .....	65
c) Shtatëportëshi .....	65
d) Harmonia .....	65
Orkomeni dhe Iliria .....	69
Eubeja dhe Ilirët .....	69

---

\* - Degë e gjuhësisë që ka të bëjë me prejardhjen e fjalëve, vetë prejardhja e fjalës, etj. [sh.përk.]

Atika dhe Ilirët .....	70
Dorët dhe Ilirët .....	75
Eolet dhe Ilirët .....	80

### KAPITULLI I TRETË

Zanafilla e Helenëve .....	82
Etimologjia e emrit kombëtar “Helenë - Hellas” .....	96
Grekët .....	98
Teoria Pellazge .....	99
Helenë - Hellas .....	110
Studimi i fenomenit helen .....	112
EPILOGU I PJESËS SË PARË .....	118

### PJESA E DYTË EPOKA HISTORIKE

#### KAPITULLI I PARË

Kohët klasike .....	120
---------------------	-----

#### KAPITULLI I DYTË

Bizanti .....	128
Ilirët dhe Krishtërimi .....	128
Sllavët dhe Arbëreshët .....	130
Kthimi i kombëtares “Ilir” në “Arbëreshë”-“Albëreshë”-“Albanë” ...	134
Shqiptarë - Shqipëri .....	136
Arbëreshët .....	137
Greqia dhe Bizanti .....	139

### PJESA E TRETË ZBRITJA E ARBËRESHËVE NË GREQI

#### KAPITULLI I PARË

Prezenca e arbëreshëve përpara shekullit të XIV-të .....	147
--	-----

## KAPITULLI I DYTË

Zbritjet e shekullit të XIV-të .....	157
1) Tesalia .....	157
2) Arbëreshët e Moresë .....	160
3) Biotia - Lorkida .....	161
4) Atika .....	161
5) Eubeja .....	161

## PJESA E KATËRT

### KRAHASIM GJUHËSOR GREQISHT – SHQIP

1. Falmerajeri .....	168
2. Nyjet .....	182
3. "V" dhe "H" përpara fjalës .....	183
4. Shqipja, nëna e gjuhës greke (idioma e parë gjuhësore helene) ....	184
5. Interpretimi etimologjik i perëndive - adhurimeve me anë të gjuhës shqipe .....	186
6. Gjenealogjia e perëndive helene .....	191
Orët dhe Mirat .....	201
Haritet .....	202
Muzat dhe Aiditë .....	203
Ritet kavire .....	204
Përfundime antropologjike .....	208

## PJESA E PESTË

### KAPITULLI I PARË

#### ARBËRESHËT E NEOHELENIZMIT

1. Veprimitaria e arbëreshëve në vitet pasbizantine .....	212
2. Manjatët - Milingët .....	220
3. Etimologjia e Manit - Moresë. Toponimet sllave .....	222
4. Ezeritet .....	224

## KAPITULLI I DYTË

### VITET E PARA TË OKUPACIONIT TURK

1. Krokondil Klada .....	225
--------------------------	-----

2. Emigrimi i arvanitasve nga Greqia e pushtuar .....	229
a) Italia dhe Sicilia - Venediku .....	229
b) Emigrimet e arbëreshëve në Kretë, Zakynth, Qefaloni, Korfuz dhe Qipro .....	237
3. Estradiotët .....	239
a) Mërkur Bua .....	241
b) Manol Bleshi .....	242
c) Koklia - Kriekuqi .....	245
Vitet parakryengritëse - Kleftet dhe armatollet .....	248

## KAPITULL PARANTEZË KARAKTERISTIKAT DALLUËSE TË ARVANITASVE

1. Ndarjet e farës së sotme shqiptare .....	253
a) Gegët .....	253
b) Toskët apo tockët .....	260
c) Lebërit .....	260
d) Camët .....	263
2. Ndërtimi shoqëror i arbëreshëve .....	265
3. Vendi i gruas në shoqërinë arbëreshe .....	268
4. Bukuria .....	272
5. Veshja arbëreshe .....	275
6. Toleranca fetare e shqiptarëve .....	280
7. Ideologjia arbëreshe - Botëkuptimi - Lidhja me lashtësinë helene ..	296
8. Mangësitë e mëdha të arbëreshëve .....	310
a) Këmbëngulja .....	310
b) Mosmarrëveshjet .....	315
c) Dyshimi - Mosbesimi i arvanitasve .....	316
9. Ndjenja burrërore dhe heroike .....	319
10. Spontaniteti - Improvizimi, etj. ....	321
11. Mikpritja arvanitase .....	322
12. Lakonizmi .....	324
13. Paragjykimet e popullit .....	324
a) Hëna .....	325
b) Lepuri .....	326
14. Garat atletike .....	327

15. Profecia dodone .....	330
16. Qethja e përparme e flokëve .....	331
17. Ndërgjegja helene e arvanitasve - arsimi .....	332
18. Estetika arvanitase .....	338
a) Kënga popullore (dhimotiko) dhe ajo rebetase .....	348
b) Dy rryma të botëkuptimit estetik .....	354
c) Ballafaqimi i këngës rebetase me atë arvanitase .....	365
d) Arsimi i lashtë muzikor - Muzika bizantine dhe arvanitase .....	366
19. Vallet arvanitase .....	368
a) Kangjeli .....	369
b) Vallja came .....	370
20. Organet muzikore arvanitase .....	374
21. Vajtimet arbëreshe .....	375
Ideologjia arbëreshe - Humanizmi (vazhdim) .....	378

### KAPITULLI I TRETË

Kleftet dhe armatollet (vazhdim) .....	384
Buej Grive .....	386
Ndërhyrjet ruse në Greqi .....	387
Mitromara .....	390
Andruco - Kaconi .....	392
Zaharia .....	394
Kacandoni .....	394
Suliotët .....	397
1) Rrufetë e Zeusit .....	404
2) Lordi Bajron .....	406
Camët dhe Beqarët .....	407
Kryengritja e Orlovit .....	407
Bardhuniotët - Laliotët .....	416
Ali Pashë Tepelena .....	421
Zonjë Frosini .....	434
Thanas Vaja .....	437
Bllahava - Nikocara .....	439
Vepra politike, reformuese dhe qytetëruese e Ali Pashës .....	444
Odisea Andruco .....	450

Aleanca Kombëtare .....	455
Odisea Andruco (vazhdim) .....	466
Karaiskaqi .....	470
Kolokotroni - Kanari - Makrijani .....	479
Veliu dhe Myhtari, bijtë e Ali Pashës .....	485

### KAPITULLI I KATËRT

Karakteri i kryengritjes greke .....	491
Pak fjalë për cështjen e Epirit të Veriut .....	545
Arvanitasit e viteve paskryengritëse në Greqi .....	548
EPILOG .....	552
Bibliografi .....	557

## NJË LIBËR QË DUHEJ BOTUAR MË PARË

Aristidh Kola lindi në Greqi më 1944 në fshatin Kaskaveli të qytetit të Fivës në rrethin e Tebës. Mbaroi studimet e larta në Universitetin e Athinës (Fakulteti Juridik) dhe punoi për shumë kohë si avokat. Më 1985 u detyrua të linte profesionin e avokatit për t'u marrë me studimin e arvanitasve, ku në të njëjtën kohë iu besua detyra e Kryetarit të Lidhjes së Arvanistasve të Greqisë. Bëri të mundur me përpjekjet e tij personale rizgjimin e lëvizjes kulturore dhe kombëtarë të traditës arvanitase. Më 1995 nis botimin e revistës "Besa" dhe të revistës 2 mujore "Arvanon". Ka botuar librin "Arvanitasit dhe origjina e grekëve", i cili është ribotuar 10 herë në Greqi, "Gjuha e Perëndive", "Greqia në kurthin e serbëve të Milosheviçit", "Fjalori krahasues i gjubës arvanitase", "Antonio Belushi dhe magjia e traditave popullore", "Proklamata e lidhjes arvanitase të vitit 1899", "Zeusi pellazgjik dhe gabimi indoeuropean". Kish te përgatitur librin "Ditari i Kosovës" dhe libra të tjera. Aristidh Kola vdiq në Athinë në rrethana të dyshimita e të përfolura. Ai njihet prej opinionit në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe kudo ku jetojnë shqiptarë jo vetëm si studjues i origjinës së tij historike, por edhe si mbrojtës i denjë i emigrantëve të pambrojtur shqiptarë në Greqi, të cilët për shumë vite janë bërë objekt i një diskriminimi të egër racial. Por mbi të gjitha, ai do të kujtohet gjithmonë prej popullit shqiptar dhe prej miqve të tij kudo në botë, për kurajon e pashebullt prej qytetari që tregoi në ambientin ultranacionalist në luftëën e drejtë që bëri Aleanca Atlantike kundra genocidit serb në Kosovë.

Emrin e studjuesit Aristidh Kola e kam ndeshur për herë të parë në librin "Kombi" para disa vite, duke lexuar essen historike të tij "Diaspora shqiptare nga pikëpamja historike". Më tërhoqi vëmendjen kultura e lartë e këtij të panjohuri, stili i të shkruarit, aftësia që ai paraqiste në shtrimin e problemeve historike shqiptare, por mbi të gjitha dashamirësia

që shprehte për shqiptarët. Më vonë më tërhoqi përsëri vëmendjen, por tashti jo më thjesht si studjues, por si njeri social, me mbrojtjen që iu bëri emigrantëve shqiptarë, që kishin shkuar për të punuar në Greqi, prej diskriminimit të hapur social që iu bënte politika e shtetit grek, por edhe vetë opinioni grek. Por aftësinë e tij kulturore dhe politike si dhe guximin e tij si qytetar i lirë e ndjeva kur lexova librin e shkruar prej tij "Greqia në kurthin e serbëve të Milosheviçit". Nëpërmjet botimit të këtij libri Aristidh Kola ishte dhe mbeti intelektuali i parë dhe i vetëm në Greqi që doli publikisht kundra qëndrimit të politikës anakronike sllavo-ortodokse të shtetit grek në luftrat e përgjakshme të shpërbërjes së Jugosllavisë. Ky libër duke vlerësuar rolin e Shqipërisë në Ballkan në mënyrë realiste dhe me një vizion perspektiv, shprehte alarmin, se ashtu si edhe në disa herë të tjera politika greke ka rënë në kurthin e shovinizmit serb, e fajtor për këtë është pikërisht shovinizmi grek.

Më vonë mësova se Aristidhi, që mezi kish pritur të hapej Shqipëria nga vet-izolimi i hekurt dhe i betontë i krijuar nga regjimi politik komunist, kishte ardhur disa herë në Shqipëri, duke shpresuar jo shumë gjëra, por të paktën atë inkurajim moral që nuk e kishte gjetur në Greqi, ta gjente në vendin e origjinës së tij të cilit i kishte kushtuar dhe jetën. Por, si duket edhe për shkak të vështirësive të mëdha politike, ekonomike dhe rënies së përgjithshme morale të njerëzve, njerëzit dhe institucionet kulturore e shkencore, nuk patën qetësinë dhe normalitetin e duhur, që t'i kushtonin vëmendje qëllimeve të mira të udhëtimeve të tij. Herën e parë kam patur rast ta takoj atë në pranverën e vitit 1997 kur Shqipëria pothuajse e gjitha ishte përfshirë në krizën e madhe të anarkisë që krijuan revoltat populllore të shkaktuara nga rënia e skemave piramidale. Me shumë dashamirësi i njohuri im, shkrimitari minoritar që tashti banon në Athinë Spiro Xhai, e njëkohësisht mik i tij, më shpuri në zyrën e shkrimitarit në katin e gjashtë të një pallati shumëkatësh, diku pranë ambasadës amerikane në Athinë. Menjëherë sa hapi derën e studios ku punonte, vura re praninë e simboleve tonë, te varura në muret e saj, ku në mes të të gjithave dallohej një shqiponjë e argjendtë. Në mikpritjen e tij kishte një cilësi të veçantë. Përveç qetësisë, urtësisë dhe ngrohtësisë, ai të shprehte edhe një vëmendje të veçantë si bashkëbisedues.

Librat e shumtë e voluminozë që i kish hapur mbi tavolinën e punës të vendosura njëra mbi tjetrën e të shoqëruara me skeda të mbushura dëshmonin sigurisht për një studiues serioz. Mes mijëra vëllimeve të vendosura ne raftet e shumta të bibliotekës, që i përdorte si referenca në punën e tij shkencore të sistemuara në një vend të veçantë, më zunë sytë Asdrenin, Çajupin, Nolin, Kadaren, Sabri Godon, por ajo që më bëri përshtypje më shumë ishte një libër shumë i vjetër i Kristo Flloqit dhe disa libra ta tjerë të rrallë me vlerë albanologjike, që ndoshta mund të mos i gjesh dhe ne bibliotekat tona më të ruajtura. Kur e pyeta se si ishte e mundur kjo gjë, më foli gjatë për arkivin shumë të pasur të bibliotekës së arvanitasve në Greqi, e cila megjithë pakujdesinë e qëllimshme që është orientuar kundra saj nga shteti dhe kisha greke ka patur duar të kujdeshme, që e kanë grumbulluar dhe ruajtur. Nga prezantimi i parë që bëra me të ndjeva se ai kishte një dëshirë, që ambicjet për botimin e librave, që kishte publikuar në Greqi, por edhe ato të cilat po vazhdonte të shkruante, donte t'i bisedonte edhe me mua. Në këtë dëshirë të tij, ai përfshinte qartë gjithçka që kishte shkruajtur, por librin "Arvanitasit dhe origjina e grekëve" e quante si një domosdoshmëri. Kjo vepër voluminoze me mbi 500 faqe, botuar 9 herë deri në atë kohë që biseduam në Greqi është një epope historike e bashkëkombasve të tij, e arbëreshëve të Greqisë, ose siç u flasin zakonisht në këtë vend, Arvanitëve. Suksesi i jashtëzakonshëm i librit i kishte sjellë kënaqësinë e madhe të arritjes së një qëllimi të hershëm, për të cilin kishte mbrritur deri atje sa të braktiste edhe profesionin e vet që i jepte aq shumë para, duke i sjellur ndërkohë edhe telashe të mëdha në jetën e përditshme. Ai ishte nga ata dijetarë bashkëkohor të Greqisë nacionaliste, që preferoi që në fatin e tij të zgjidhte atë të të ecurit kundra kësaj rryme. "Libri "Arvanitasit dhe origjina e grekëve" është një vepër që i ka kushtuar përveç shumë problemeve, që i ka hapur me politikën, kishën dhe historiografinë greke i ka marrë shumë kohë dhe i ka kushtuar mjaft mundime. Për veprën është përgatitur dhe e ka shkruajtur kur Shqipëria jetonte nën diktaturën komuniste dhe vendi ku jetonte ai, Greqia, i kishte ndërprerë marrëdhëniet me të, për shkak të ligjit absurd grek të luftës, por edhe për arsyet e armiqësive ideologjike dhe politike. Aristidh Kola e ushtroi veprimtarinë e tij si studjues dhe historian në kushte specifike për një mendimtar të lirë. Greqia vërtetë, që ishte një

vend që perëndimi kishte sakrifikuar jo pak për ta mbajtur në kahun e tij ndryshe nga kampi, që kishte mbetur Shqipëria, ku me një ndryshim prej saj, gjeje liri, ku të shprehje mendimet dhe idetë e tua. Por në rastin konkret me Greqinë ishte sikur të luaje me zjarrin. Nuk ishte e lehtë që të bëjë beteja të tilla teorike dhe të mbrojë ato që kishin të bënин me një problem etnik dhe shpirtëror në një kohë kur Greqia me artopalant të tipit Sebastianos “vajtonte” përfatim e mjerë të tokave të saj, që gjoja kishin mbetur përtej kufive të saj dhe betohej dhe hakërrrehej se do të vinte koha që ti përfshinte me forcë në territorin e saj. Në këtë realitet ai punoi dhe me përpjekje shkencore e guxim heroik u dha frymëmarrje arkivale jetës kulturore-historike të arvanitasve, duke e ringjallur atë. Edhe pse dora e tij pas gjithë atyre gjërave që kanë ndodhur me Arvantinë në Greqi është si e akullt, si e padukshme diku në shkëputje e diku në thermim , ajo ka me vehte forcën e të vërtetës historike, që të rrëmbej stafetën e brezave paraardhës, stafetën e djemve të Shqipërisë, që i dhanë lirinë Greqisë së re moderne. Me këmbanën e tij, që është e vërteta historike e një populli me vlera të larta liridashëse dhe paqedashëse dhe me kontribut të pazëvendësueshme në lirinë dhe prosperitetin e Greqisë së re, ai kërkon që të tërheqë vëmendjen e gjeneratave pasardhëse përfundimtare që ka ndodhur përfundimtare përfundime të cilat mund të mos ndash të njëtin mendim me autorin, të cilat mund të lidhen me subjektivizimin e tij si pasojë e ndonjë problemi të paverifikuar mirë, por në përgjithësi vepra është një vlerësim përfundimtare e kombit shqiptare prej nga nis dhe historia e këtyre njerëzve, që ka përfundimtare ky libër. Në një qell të veshur me shumë re, në një terren të vështirë politik dhe etnonacionalist ai bëri publike studimet e tij shumë vjeçare, duke replikuar jo vetëm me historiografinë greke që po bën rolin e të paditurit mbi identitetin e arvanitasve, por dhe me politikanë dhe qeveritarë grekë, të cilët nuk kanë guxuar as që të belbëzojnë, pale ta pranojnë realitetin historik të pranisë etnike të shqiptarëve në Greqi.

Rëndësia kryesore e librit është se ai ka një karakter shumë dimensional. Problemi më themelor i librit është vërtetë prejardhje e arvanitasve, të cilën ai e zë nga rënjet dhe e çon deri tek trungu i saj i mohuar kriminalisht në fshehtësi nga kisha dhe shteti grek nëpër shekuj. Por këtë absurditet historik, e vë përballë lidhjeve dhe afersise qe kane ekzistuar sa mbahet mend nermjet grekerve dhe shqiptareve. Këtë arsyetim ai nuk hallakatet që ta kërkoj sâ andej-këndej, por i rezulton nga faktet historike, i vjen natyrshëm nga historia. Po të hetohen qorrskakat dhe antitezat e historianëve në lidhje me pellazgët do të kuptojmë se atje ka një handikap ku e para gjë që të shkon ndërmend është se atje ka hije politika, e cila historianë, në këtë kapitull të saj e ka kthyer në pseudohistori. E njëjtë gjë dhe i njëjtë keqkuptim shtyhet dhe sofistikohet edhe sot, kur nga njëra anë thuhet se shqiptarët dhe grekërit vijnë nga pellazgët dhe nga ana tjeter bëhet e pamundur për të vënë kufinj të këqinj, duke u çjerrur të shkëputin Epirin e Veriut se është helen. Për pellazgët që na flisnin ata gjigandët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare të shekullit të kaluar, s'bëhet me fjalë. Ndërsa historianët neogrekë as duan që t'i pranojnë ata, ku sipas tij, herë janë helenë dhe herë para helenë. Domëthënë, herë të bardhë dhe herë të zezë. Por sipas analizës se autorët pellazgët nuk janë plangprishës, që t'i nxjerrin nga horizonte dhe gjërat të shkojnë në vendin e vet dhe kështu ne të qetësohemi. Pellazgët nuk janë miza në qumështin tonë, që na ka rënë brenda dhe sipas një arysetimi të keq të historiografisë greke, ne duhet që të nxjerrim Mizën dhe të pimë qumështin. Ata gjenden kudo, sipas autorit. Gjënden në gjuhën shqiptare dhe në gjuhën greke. Gjënden në peripecitë dhe përpjekjet tona. Gjënden në atë që na vë në lëvizje të marrin rrugët dhe të bredhin në çdo kënd të botës, të krijojnë atje, por edhe të kthehem si Odiseja në Itakë. Gjënden në adhurimet midis feve që na imponuan. Gjënden në levenderine krenarinë, egoizmin, dinjitetin, gjenialitetin, në aftësinë të ekzistojnë dhe ta bëjmë të ndjeshme prezencën tonë, me gjithë kushtet e vështira që jetojmë.

Ekzistojnë në natyrën tonë, kur përpiken për të bërë të pamundurën, kur luftojnë atje ku nuk e dimë nëse do t'ja dalim mbanë. Gjënden në guximin dhe marrëzinë tonë, kur shpesh themi, jo kur të tjerët thonë po. Përpjekjet për zhdukjen e komunitetit të madh arbëresh (arvanitas)

të Greqisë janë një krim i shëmtuar i Greqisë së re, e cila i ka hedhur për rreth 4-5 shekuj baltë përsipër sistematikisht me qëllimin e përcaktuar për ta mbuluar. Ai ka marrë përsipër, që me kurajo ta çvarrosë shkencërisht këtë krim. Dhe filozofia e arsyetimit të tij bëri fajtor për këtë kishën, shtetin dhe jo komunitetin arvanitas, që është rrezikuar seriozisht nga asimilimi duke transformuar tragjikisht në një komunitet linguistikë. Shqiptarët e Shqipërisë dhe shqiptarët e Greqisë nuk kanë qënë kurrë të përfaqësuar në një bashkim të vërtetë shpirtëror. Edhe në ato momente të historisë kur kufitë kanë qënë të hapur, këtë përfaqësim e kanë penguar herë forcat e një ideologjike të fymëzuar me shpifje, dizinformime dhe herë forca e ligjit dhe e hakmarrjes shtetërore për të shuar forcën e rracës dhe për të mos thënë qetësisht kush ishe, nga vjen, dhe kujt origjine i përkisje. Fitime, humbje, lavdi e disfatë, gjëzime dhe hidhërimë dhe shumë peripeci, mbetën epopeja e largët e një rrace të gjallë, e cila për t'i shpëtuar ndëshkimit të një pushtuesi ra nën thundrën fatale të një shtypësi tjetër. Libri në fjalë është një vlerësim i teorisë së helonologut të madh gjerman Falmerajer për kontributin e shqiptarëve, duke u mbështetur teorinë e Falmerajerit, por dhe duke e mbështetur atë me fakte të tjera. Shqiptarët, përtej të qenit gjithmonë një ishull midis kombeve të tjera, duke përballuar të gjitha llojet e pushtimeve në vitet pas klasike mbeten gjithmonë një popull i pacenuar dhe i paprekur nga çdo ndikim dhe influencë e huaj. Dhe mënyra e ndërtimit të shoqërisë së tyre, sipas fisesh dhe klanesh së bashku me karakterin e ashper e të panënshtrueshëm të tyre, iu siguroi mbijetesën përtej shekujve, gjë që Falmerajeri e pranon dhe e konfirmon plotësisht.

Duke kuptuar faktin që shqiptarët ishin të detyruar per shekuj me radhë të jetojnë nëpër male me armë në dore, për të ruajtur parimet e tyre të trashëguara, të lirisë, krenarisë, mosbindjes dhe pastërtisë së rracës, deri në ditët e sotme, nënkuptohet dhe konservatorizmi i tyre.

Tuqididi ka thënë se helenët janë shumë të afërt dhe të një gjaku me ilirët. Sigurisht, që historiani i lashtë e ka patur fjalën për grekët e lashtë. Por, sidoqoftë në Greqinë e sotme ekzistojnë forca shkencore dhe politike që s'lenë gjë pa bërë për t'i shkatërruar ekspozime të tillë. Mbi të gjitha, historianët grekë kanë folur shumë me heshtjen e tyre, ku me anë të së cilës kanë patur gjithmonë si qëllim që ta shmangin

shqyrtimin e problemit arvanitas. Momente historike të cilat dikur ishin realitetë të gjalla, ku Athina kryeqyteti i Greqisë gëlonë nga komplekset e helenizimit apo shqiptarizmit, pra në ishe grek apo shqiptarë, ishin të frikshme për t'u kujtuar, pa lëre më për ta përsëritur në Greqi. Pikërisht kjo hamëndje paranojake frymëzoi organizimin e luftës së fshehtë, të heshtur dhe sistematike disa shekullorë, kundra gjakut shqiptarë në Greqi, i cili më së shumti identifikohet me arvanitët; luftë, që me themelimin e shtetit shqiptar u shoqërua edhe me të ashtuquajturën “megalloide”, e cila sot herë bën sikur fle dhe herë zgjohet, por gjithësesi ujërat e miqësisë midis dy popujve po i trazon dhe po i turbullon për mrekulli.

Libri “Arvanitët dhe origjina e grekëve” është një libër për të cilin unë kam menduar se duhej ta kishte parë dritën e botimit që më parë në Shqipëri. Këtu nuk është fjala për të nderuar figurën e respektuar të një personaliteti, i cili i ka mbrojtur publikisht shqiptarët në momente të vështira, duke e identifikuar vehten hapur me ta, por edhe vlerat e rëndësishme historike, politike dhe estetike që ka për ne. Këtë dëshirë, që kishte edhe autori dhe që i ziente përbrenda ma tha që në takimin e parë. Në takimin e dytë që bëra rreth 3 vjet më vonë, ai m'u drejtua drejtpërdrejt për ta botuar librin e tij në Shqipëri. E kishte humbur besimin tek një botues tjeter, që e kishte marrë përsipër 4 vjet më parë, dhe ndoshta ishte trembur nga leverdia ekonomike por që cuditerishte refuzimin e kishte shprehur me heshtje e shmangje. Në brendësinë e kësaj periudhe 3 vjeçare kishin kaluar shumë ngjarje. Shqipëria kishte kapërcyer hendekun e madh të krizës së vitit 1997 dhe NATO kishte sulmuar ushtarakisht serbin e Milosheviçit, për të shpëtuar shqiptarët e Kosovës nga genocidi masiv. Pjesëmarrja aktive e Aristidhit në debatet televizive në Greqi rreth ngjarjeve të Kosovës, tregoi qartë shpirtin e shqetësuar të tij, përcolli në opinionin grek të vërteta historike, sikurse ato që përshkruhen në këtë libër, të cilat edhe pse të përbaltura në sipërfaqe, aty thellë në thellësi të historisë të shekujve, ato kanë mbetur të paprekura, prandaj kanë dhe do kenë përkrahësit e tyre të denjë.

Por herën e dytë që unë u takova me të, ai m'u drejtua personalisht për ta bërë të mundur botimin e tij. Gjendja ime financiare si botues nuk e ofronte këtë mundësi për të botuar një libër voluminoz me format të madh dhe me mbi 500 faqe. Botues matrapazë, që librin e kanë vetëm

si koperturë për t'i rrëmbyer shtetit tenderat, të lidhur me pushtetarë, duke na i grabitur pothuaj shumicën e ndihmës që japid fondacionet para shtetëror siç është fondacioni "Fan Noli" dhe mundësi të tjera, që të jep shteti na i kanë bërë më të vështirë periudhën e tranzicionit. Për këtë arsyе i shpreha dëshirën time për të bërë diçka, por nuk ja mora përsipër. Në këtë udhëtim në Greqi unë isha pjesëmarrës në një Panair Ndërkombëtar Libri në Athinë dhe mendova, se do shiheshim përsëri në Stendën e Shtëpisë Botuese "Phoenix", të cilën e drejtoj unë, ose në promovimin e librit te bere prej tij, që ia kushtonte Antonio Belushit, aktivitet ky që ishte planifikuar për t'u bërë në një nga ditët e këtij panairi. Por, ndërsa unë e prisja me kënaqësi që të vizitonte për herë të parë librin shqip, një ditë më vjen miku i të dyve, shkrimtari Spiro Xhai dhe më thonë se Aristidhi ishte shtruar papritur në spital dhe gjendja e tij ishte e rëndë. I shkoj pikërisht atë mbrëmje në spitalin shtetëror "Vangjelizmo" në qendër të Athinës dhe krevatin e tij e gjej në gjendje të mjerë në një nga koridoret e katit të gjashtë pranë një pike telefonike, ku flisnin të sëmurët. Nuk m'u duk e rastësishme, që nuk u gjend një dhomë për të në atë zheg të nxeh të asaj vere për një njeri, që kishte bërë revolucion në mendimet e shumë njerëzve me një libër të tillë në Greqi. U takuam dhe biseduam, ja aty pranë krevatin e tij. Biseda në gjuhën shqipe po tërhiqte vëmendjen e mjekëve që kalonin nga dhoma në dhomë. Megjithatë, ne vazhduam bisedën në shqip.

"Mik i dashur Ndriçim" - më tha gjatë bisedës. Në qoftë se unë do bëhem përsëri mirë në do bëjmë gjëra të mira bashkë, por më kujtoi sërish librin".

Kuptova se diçka serioze kishte ndjerë për shëndetin e tij dhe në fund të bisedës i thashë se nuk ishte keq të kisha librin e tij në dorë. Mbas dy ditësh ai del nga spitali i "Vangjelizmo", i sëmurë në gjendje jo të përshtatshme për të lëvizur dhe shkon në zyrën e tij, merr atë pjesë të librit të përshtatur në shqip dhe ma dorëzon mua. E mora librin duke menduar shumë kohë për botimin e tij. Autori mbas dy-tre muajsh vdiq tragjikisht nëpër korridoret e spitaleve të Athinës si një njeri i braktisur, në një moshë që ishte përgatitur për të shkruajtur. Kërkova por nuk arrita që të siguroj një ndihmë të thjeshtë financiare për botimin e këtij libri. Shteti i sotëm injorant shqiptar, ja ka mbyll portën fare

publikimit të letërsisë klasike dhe të mendimit shqiptar. Thonë se aktualisht burokracia jonë shtetërore po përgatitet ta nderoj me një dekoratë këtë personalitet të shquar shqiptaro-grek, i cili megjithëse në rrethana dhe në një terren tjetër, më kujton klasikun De Radë. Sigurisht, që nga halli, edhe këtë mund ta quanim një gjë të mirë. Por mendoj se përpara ketij nderimi duhej të ishte bërë një projekt për botimin e librave të tij, të cilat i bëjnë shërbime Shqipërisë dhe kombit shqiptar ose t'i ishte vënë emri i tij një shkolle, ose ndonjë rrugë në Tiranë apo në qytetet e tjera te Shqiperisë.

nga Ndriçim KULLA

## PARATHËNIE

Në qoftë se njohim të shkuarën tonë (historinë), atëherë mund ta shfrytëzojmë më efektivisht të tashmen dhe të projektojmë me më pak gabime të ardhmen.

Kur miqtë e mi më pyesnin, përse merrem me këtë kërkim dhe për më tepër me prirje monomanie të tepruar, nuk e kisha të gatshme përgjigjen.

Dicka tjetër ma ngacmonte më shumë dëshirën, që bëhej si lumë llave, sa më shumë përparonte kërkimi, sa më shumë ditë pas dite, ngrija me vështirësi, ankth dbe habi shtresën e ndryshkur e të rëndë shumëvjeçare, që mbulonte figurat e ngurta të paraardhësve të mi, të palekundur, të beshtur, të fuqishëm e padrejtësish të trajtar.

Dhe ata - si gjithmonë - nuk flisnin, por në vështrimin e tyre të ngurtë shihja që orë pas ore, dite pas ditë më imponohej vetëtimthi, mw mbyllte gojën dbe më kanosej: "Ç'më rri kot?... Nuk shikon që na u bë e rëndë shtresa që na zuri? Akoma dbe romët flasin për Trimëri, Besë dbe Krenari... dhe soji ynë që i kish këto si mish me thoin dbe virtyt të tij, barrohet, zhduket dbe humbet".

Por gjatë kërkimit, vura re me çudi të madhe se "varrosja" nuk kishte të bënte vetëm me arvanitasit, paraardhësit e mi të menjëhershëm, por dbe me vetë helenizmin. Në mes të zemrës së helenizmit, në Gregi, është bërë një përpjekje shumëvjeçare, të "varroset" çdo gjë helenike. Po përse të varrosurit e parë të jenë arvanitasit? Ç'lidhje kanë me helenizmin? Veprimet e gjendjes civile që kanë bërë këta varrmihës, na vërtetojnë se arvanitasit janë një 'pakicë' në Gregi. Përse, pra, të jenë ata të parët në grykën e topit të tyre?

Ushtyu kështu, automatikisht, të kontrolloj lidhjet e arvanitasve me grekët, duke filluar nga helenët e viteve paraklasike dhe duke u dhënë peshë kryesore atyre, që janë vërtetuar dhe që pa asnje lloj dyshimi ishin helene. Rezultatin e krahasimit, është e vërtetë se as unë nuk e prisja. Faktet e

*ndonjë lidhjeje të mundshme midis arvanitasve me helenët e lashtë ishin vetëm pak gjuhësore, ndërsa faktet e identitetit të helenizmit të ri me arvanitasit janë të bollshme dhe nuk më krijoi probleme vërtetimi i çështjes se arvanitasit janë krijuesit e Greqisë së Re. Veç kësaj, dhe dokumentat (megjithë falsifikimin ose mospermendjen e tyre) janë të shumta dhe të kohëve të fundit.*

*Po me helenët e lashtë, që përveç se të lashtë ishin pa dyshim helenë, si i bëhej? Shumë njerëz, na e kanë vënë në dyshim lidhjen e drejtperdrejtë dhe afërsinë me këtë popull të lashtë helen. U dhanë shumë përgjigje nga intelektualët grekë, që ishin të detyruar t'i pranonin si greke, arvanitasit kryengritës të 1821 dhe, si rrjedhim, nuk do të ishte e mundur të arsyetonin shumë gjëra, si psh. qe gjysma e tyre u shndërruan në myslimanë gjatë pushtimit turk dhe më e rëndësishmja, që flisnin një gjuhë "barbare".*

*Por gjuba ishte dëshmia e "pamposhtur" e intelektualëve grekë në luftën e tyre për të treguar vazhdueshmërinë e pathyeshme të helenizmit, rrjedhimisht çështja ose ndoshta "vërtetimi" i saj ra pre e një qarku të shkurtër. Historianët grekë me Paparigopulon në krye, me qëllim që t'a mënjanonin këtë qark të shkurtër, përdorën metodën e "murgut dinak". Për ata që nuk e dinë, murgu dinak u gjend një ditë të agjwrimit në një shtëpi ku shurbehej për të gjithë të ftuarit e tjerë, peshk i pjekur, ndërsa për ata që ageronin, perime, ullinj dhe qepë.*

*Por murgut tonë, nuk ia mbushën syrin perimet, duke patur përparrë peshk të pjekur, por gjithashtu nuk donte as të tregonte veten në sytë e Zotit dhe të të tjerëve. Kështu që u çua dbe pas një lutjeje të shkurtër, i bekoi peshqit që të shndërrobeshin në... fasule dbe u shtrua tw hante peshkun.*

*Kështu dbe historianët tanë \*, emërtuan "grekë" të gjithë heronjtë e krishterë arvanitas të 1821-sht dbe quajtën "arvanitas" ose "turkarvanitas" ose "shqiptarë" të gjithë arvanitasit që ishin myslimanë. Ky ndërtim, i lehtësonte, jo vetëm të flasin keq e të shajnë të gjithë arvanitasit pa përashtim, por dbe të bëjnë një ndarje të trilluar midis grekëve dbe arvanitasve, në mënyrë që të duket dbe në sytë e të buajve se ne, "grekët", nuk kemi asnjë lidhje me arvanitasit. Njëkohësisht shpallnin kudo se "çdo gjë kombëtare, është e vërtetë" dbe ndërkohë e vërteta kërkonte të drejtat e saj...*

---

\* Siç do të vini te dhe në vazhdim të librit, autori flet në vetën e parë dhe si qytetar grek. Prandaj nuk duhet të merrni shprehjet "historianët tanë" e të tjera të ngjashme, me kuptimin "historianët shqiptarë", por "grekë". [shën. i përkth.]

Pra, duhej tē kontrollohej efektivisht çështja e lidhjes së arvanitasve me helenët e lashtë dbe një përpjekje e tillë, dukej që në fillim e dënuar tē dëshkonte, megjithëse dritarja e parë për suksesin e saj ishte e hapur që nga fundi i shekullit të shkuar. Kjo dritare ishte fakti se gjuha arvanitase nuk ishte dbe aq barbare sa dukej, por kishte lidhje jo me çfarëdolloj dialekti, por me atë tē Homerit.

Domethënë ishte bërë tanimë një pikënisje me bazë shkencore mbi lidhjen e arvanitasve me helenët e lashtë. Pasuan mjaft studime tē tē huajve dbe tē grekëve mbi këtë temë, që megjithëkëto, mund tē thuash se ndodhet akoma në fillimet e saj dbe ruan surpriza në çdo kërkim, sepse çdo studiuës i ri shton fakte tē reja gjuhësore nga anë e tij.

Pra dbe një studim gjuhësor, pak gjëra do tē shtonte në zbulimin e lidhjeve tē arvanitasve me grekët e lashtë. Dubet tē ekzistonin dbe elemente tē tjerë krahasues. Kjo, ose u konsiderua e pamundur, ose e tepërt nga ata që u mjaftuan me vërtetimin e krahasimit gjuhësor, ose ishte e pankonceptueshme.

Por unë, në mënyrë paradoksale, besova që në fillim se krahasimi gjuhësor duhej tē ishte elementi i fundit dbe kurorëzues i tē gjithë elementëve tē tjerë krahasues, për tē vërtetuar identitetin e përbashkët tē arvanitasve me helenët e lashtë.

Fillimi isht ekzistonte çështja e fesë ose ndoshta për tē qenë më tē saktë çështja e sistemit tē abdurimeve tē helenëve, me veçanërinë e saj tē papërsëritshme. Ç'lidhje mund tē kishin arvanitasit me tē? Helenët kishin një besim tē theksuar personal, shoqëror, politik dbe ideologjik, një mënyrë tē veçantë jetese, botëkuptimi, qëndrimi ndaj bashkëjenjeriut, ndaj mikut dhë armikut, jetës dbe vdekjes. A kishte ndonjë lidhje dbe përputhje me ato tē arvanitasve? Ekzistonin zakone dbe doke tē veçanta, estetika si dbe koncepte tē tjera. Cila ishte pra, lidhja e tyre me ato tē arvanitasve? Sigurisht, pas kaq mijëvjeçarësh dbe ndikimesh si dbe vonese kulturore, mund tē thuash se edhe sikur arvanitasit tē ishin ajo që mbeti nga lashtësia greke, përsëri ngjashmëritë duhet tē jenë tē pakta.

Por studimi krahasues, siç do ta vini re, vërteton se arvanitasit shpjëtuani aq mbetje tē lashtësisë greke saqë e vështira tashmë nuk është tē tregosh në kanë lidhje tē drejtpërdrejtë me helenët, por e kundërtat.

Me studimin krahasuses arvanitaso-helen, m'u dha rasti tē konstatoj atë që përmenda dbe në fillim: "Varrosjen" e helenizmit d.m.th., çgregizimin tonë tē rrezikshëm, që në shumicën e rasteve konsiderohet si "arritje e re".

Për një përfytyrim të tillë të rremë, duhej të bindeshim dhe u bindëm. P.sh., Kondoglu dhe miqtë tanë nga Azia e Vogël, na bindën se figurat arteriosklerotike të shenjtorëve të tij me veshjet hebraike, janë traditat mw autentike popullore greke që mund të paraqesim në fushën e piktures moderne.

Buzuku përfundoi si instrumenti ynë kombëtar dbe pshëritim, me tw cilat na nanurisin ose na zgjojnë në agim rebetasit e radios ose të televizorit, cilwohen si arsimi ynë muzikor kombëtar.

Cifteteli dbe karcilama janë bërë vallet tonë kombëtare dbe propagandohen si të tilla nga producentë (muzikorë) dbe ndërmjetës dinakë.

Karagjozi dbe Haxhiuati konsiderohen si tipat popullore përfaqësues të grekut, etj.

Janë këto perceptime të ngrira tashmë të viteve të fundit dbe n.q.se guxon t'i vwsh në dyshim ose t'i kundërshtosh, atë që për shekuj dbe mijëvjeçarë ishte me të vërtetë greke dbe autentike popullore, do të trajtohesh si orator kinez, në Sheshin e Kushtetutës...

Megjithatë guxoj të them se tashmë po paralajmërohet vdekja politike e helenizmit nën tingujt e buzukut, nën pshëritimat e rebetave dbe me shoqërimin muzikor me xhaz e me rok. Arvanitasit, ashtu siç i bënë balëw çdo pushtuesi të huaj, po ashtu do të rezistojnë dbe tani.

Arvanitasit, ashtu si helenët e lashtë, shquhen se brenda tyre ekziston një ballafaqim i barabartë dbe i vazhdueshëm i një progresiviteti dbe konservatorizmi. Progresiviteti i tyre, fut elemente të huaja dbe konservatorizmi i filtron në mënyrë aq efektive, saqë bidhen poshtë gjërat e tepërtë dbe të padobishme dbe rezultati i dëshiruar të shartohet në mënyrë të tillë, saqë të krijohet gjëja "ë tretë" e re dbe e bukur. Progresiviteti është po aq i rëndësishëm sa dbe konservatorizmi! Por kjo gjë nuk kuptohet sot, sepse neoheleni është bërë ithtar i rrjeteve të ndryshme. Nuk është person arsyetues i vetëpushtetshëm, por ithtar. Partiak, politik, fetar, sportiv, artistik. Domethwñw ndjek, nuk udhëheq. E zhvendos veprën "ë vështirë" të qëllimit, të mendimit, të përgjegjes, të ekzistencës së tij në fund të fundit, tek dikush tjetër ose tek disa të tjera që rrjedhimisht i përfytyrojnë si gjysëmperëndi.

Por n.q.se beqim veshjen e ittarit, veshjet e fanatizmit, që do të thotë mungesë mendimi dbe gjykimi dbe studiojmë me kujdes dbe pa u ndikuar nga çështja greke, si e shkuar, e tashmë dbe e ardhme, atëherë do të shohim se të jesh grek, ose të jesh arvanitas nuk është thjesht një çështje e një certifikate zyrtare, por mënyre jetese. Një pozicion politik, shoqëror, estetik dbe

*perceptim. Ai pozicion dbe perceptim është në gjendje të ndajë se çfarë elementesh duhet të thithë dbe çfarë të hedhë poshtë.*

Që të rikthehem i në veçantinë e temës që janë arvanitasit, mendoj se kërkimi rrëth tyre dbe posaçurisht kërkimi rrëth gjuhës së tyre, do të zgjidhë shumë probleme të pazgjidhura deri më sot, kryesisht të periudhës prehistorike. Mjaft gjëra dbe perceptime të ngrira nw tw vurtetw duhen rivlerësuar. P.sh., gjuhëtarët i përfshijnë të gjitha fjalët e pastudiuar nga ana e prejardhjes së gjuhës greke dbe latine tek ndonjë (me hamendje) fis ose gjuhë jape apo indoeuropeiane. Por shumica e tyre nuk janë të panjobura për arvanitasit!

Deri para pak kohe, besonim se shumica e fjalëve të gjuhës arvanitase, që takohen në sllavisht, bullgarisht, rumanisht, turqisht, frëngjisht, gjermanisht dbe anglisht nuk ishin veçse huazim i arvanitasve prej këtyre popujve. Por arvanitasit shquhen për mospërvetësimin dbe konservatorizmin e tyre ndaj marrjes së elementeve të huaj dbe përsëri nuk është e lehtë të pranosh që francezët u dhanë arvanitasve pjesëzën mobuese PAS, ose që anglezët u dhanë hua emërtimin e ditës së parë të javës, e cila në të dy gjuhët do të thotë "dita e diellit" (Sunday në anglisht, E diel në gjuhën arvanitase). Tek arvanitasit ekzistojnë më shumë prejardhje nga rrënja Di- (Diell, Dite, Dieg = djeg, Di = njoh ose ndriçohem, etj.), si dbe një sistem të lashtë adhurimi në lidhje me Diellin dbe Nënën tokë, ndërsa fjala angleze Sunday është e zhgozhduar dbe e pastudiuar nga të dhënat angleze. Pra, kush huazoi dbe nga kush?

Ukrijuan kështu një seri pyetjesh gjatë këtij studimi dbe mund të thuash se shtrohen shumë çështje për herë të parë, theksohen rrugë studimi dbe kërkimi të ardhshëm, hapen mbas dyer të vulosura të historis së njerëzimit. Pesha e këtyre studimeve mendoj se me siguri do të jetë e pallogaritshme për historinë e Greqisë, sepse do të kemi hyrë në rrugën e vërtetimit të atij përfundimi të mësuesit të madh të Jenosit \*dhe militant, Jenadhios, që thotë: "Arvanitasit ose albanët, ose shqiptarët, janë përfaqësuesit më autentikë të Ilirisë pellazge, d.m.th., grekët në këtë fazë themelore". Këtë përfundim nxori Jenadhi nga studimi krahasuses i gjuhës dbe filologjisë, por ky studim referohet në një sërë krahasimesh të tjera, referohet tek mitet, tek legjendat dbe tek traditat e helenëve të lashtë, në dëshmitë historike, tek doket, zakonet, bindjet, idetë, perceptimet, tek sistemi adhurues dbe fetar, studimi i të cilave çon në rezultate të mahnitshme, si dbe synon të lidhë fijet e helenizmit (që i preu hyrja e krishtërimit me Bizantin) nga vitet e lashta prehistorike, deri

më sot, me një mënyrë më kompakte dhe jo me ndërlidhje të sajvara, të zbuluruara, gjithnjë të diskutueshme dhe thelbësishët të paqena. Krahasimet, nuk bëhen në mënyrë të veçuar (p.sh. vetëm gjuhësore ose vetëm folklorike), por të bashkëlidhura dhe që plotësojnë njuri-tjetrin, në mënyrë që njëri të vërtetojë të tjerët. Njëri të lidhet në mënyrë natyrale dhe arsyetuese me tjetrin.

Dua gjithashtu të theksoj se ky libër, përveç të qënë përbledhës, përveç vëllimit të tij, mund, ose sigurisht që do të ketë vlerësimë të gabuara dhe në asnjë rast nuk synon të bëhet manifest ideologjik për arvanitasit ose grekët. Nuk u besoj të pagabuarave dhe më pëlqejnë gabimet e kërkuesve të ndryshëm, kur ata kanë shfrytëzuar të gjithw kufijtë e përpjekjes së tyre. Një vlerësim i gabuar, një përpjekje e gabuar nga ana studimore, mund të çojë një kërkimtar të ardhshëm në zbulime të mëdha.

Një libër kërkimi, pa gabime, është një libër jopjellor. Në asnjë rast ai nuk do "të lindë" një libër tjetër.

Ky libër, pra, sigurisht që mund të ketë gabime, por gjithmonë aq sa nuk e humb bukurinë dhe vlerën e përpjekjes revolucionare studimore, në tërësinë e saj.

Përsa i përket historisë së kohëve të fundit të arvanitasve në lidhje me Greqinë e Re dhe luftën e 1821 -shit, studimi kufizohet në zbulimin e nyjeve të panjobura e të keqkuptuara si dhe në studimin e ngjarjeve, të pastudiuarë deri më sot, që i ndajnë arvanitasit nga grekët, duke krijuar një zbrazëti, të cilën e mbuluan me çështje ndjenjash e trillimesh.

Duke përfunduar, e quaj si detyrim të falenderoj (pa i purmendur me emra) të gjithë miqtë, që më mbështetën shpirtërisht dhe materialisht në përfundimin e kësaj vepre me kaq shpenzime, sepse sinqerisht do të ishte e pamundur diçka e tillë me përpjekjen time personale, që nga çasti, që vendosatë kapërcej garën e kushtuar të tregtisë dhe të reklamave.

Këtë libër ia kushtoj prindërve dhe të gjithë paraardhësve të mi, që pavarësisht se janë trajtuar me padrejtësi, e ruajtën thelbin dhe përbajtjen e helenizmit, si prush të shenjtë e të pasuar.

Athinë, shkurt 1983

---

\* - Shkolla e Madhe e Kombit që pasoi Akademinë Patriarkane. Jepej mësimi i fesë si dhe shkencat e tjera të kohës (shek. XVI dhe XVII), por rendësia më e madhe i jepej teologjise. [sh.përkth.]

## SHËNIM I SHTËPISË BOTUESE "THAMIRIS" (për ribotimin e 8-të)

Ribotimi i tetë i kësaj vepre tashmë klasike, i shtohet botimeve "Thamiris" dhe problemi ynë kryesor i përket faktit se u desh të bënim një riparim tërësor të veprës dhe korrigjime kryesisht drejtshkrimore.

Botimi i parë i librit ishte një përpjekje personale e autorit duke përfshirë në të të gjitha disavantazhet që paraqesin botime të tilla.

Megjithatë arriti të realizojë 7 ribotime (diçka e rrallë për botime vetjake) falë përbajtjes së tij, që 13 vjet pas botimit të parë vazhdon të gjendet në qendër të interesit të lexuesve.

Një ndërhyrje thelbësore e veprës, siç do të donte tani autori, do ishte dhe e kushtueshme dhe do të ndryshonte karakterin e saj, që nuk përbën një pamflet historik, por një kushtrim për ndërgjegjësimin kombëtar, historik dhe kulturor.

Ndërhyrjet, pra, janë kufizuar në minimum, është shtuar ndërkohë një pjesë shënimesh në sektorin përkatës pas pjesës së parë të librit, ku autori shton ose shpjegon elemente, që i konsideron të nevojshme të shpjegohen pas ngjarjeve historike të viteve të fundit.

Athinë, Maj 1996

## H Y R J E

Më 1897, themelohet në Greqi shoqata me emërtimin "LIDHJA ARVANITASE" me kryetar Marko Dh. Noti Boçarin dhe anëtarë të gjithë pasardhësit e prijësve të famshëm të 1821. \*

Ata përpiken të bindin mbretin Gjergj I se në prag të zhvillimeve në Ballkan se "... nëse nuk realizohet pakti me arvanitasit e islamizuar të zonës lindore të vendit, sigurisht... Greqia e lirë edhe vetëm me kontribut të arvanitasve të krishterë do të mund të luajë rol kryesor..., por gjithashtu është e sigurt se pa ndihmën e të parëve nuk do të arrijë të kufizojë kërkesat përbuzëse e të pabaza të bullgarëve, serbëve dhe rumunëve". Njëkohësisht Lidhja dërgon tek shqiptarët një thirrje, ku midis të tjerave theksohet : "Vellezër... sado që na ndajnë vendi dhe feja, nuk pushojmë së qëni vellezër... Duhet ta lëmë mënjanë armiqësinë që na shkaktoi Turqia dhe Fetë... Në zemër të popullit grek dhe shqiptar është rrënjosur ndjenja e afërsisë... Greku para se të bëhej grek, ishte shqiptar, dmth. pellazg... Grek do të thotë shqiptar i civilizuar".

Nënshkruajnë M.N.Boçari, Xhavela dhe Shehu<sup>1</sup>.

Mjaft vjet më parë, në vitet e flakta të '21 dhe më saktë me 23 gusht 1821, Dh.Ipsilanti si i dërguar i regjimit, u çon aleatëve (të deriatëhershëm) arvanitas myslimanë, letër përgëzimesh për kontributin e tyre në fitoret e para të Revolucionit dhe në mes të tjerash shkruan:"...por ju o toskë burrërorë, nuk keni origjinë nga orientalët shpirtvegjël, as nga sqithot e

---

\* - Bëhet fjalë për kryengritjen greke të 1821, e quajtur "kombëtare" nga vetë grekët, që synonte çlirimin nga zgjedha osmane dhe krijimin e një shteti të pavarur grek. [sh.përkth]

1- Në këtë lidhje marrin pjesë të gjithë fëmijët e të gjithë heronjve të revolucionit të 1821.

pafamshëm. Jeni pasardhës të heronjve tanë paraardhës... dhe emri juaj do të mbetet pa asnjë dyshim i pavdekshëm, i dëgjuar dhe i lëvduar në të gjitha Mbretëritë e Tokës..."

Pak kohë më pas gjërat do të ndryshojnë dhe "pasardhësit e heronjve tanë paraardhës" do të bëhen papritmas "turkoshqiptarë", "arvanitas", etj.

Vitet kalojnë, Greqia çlirohet, vritet Kapodhistria, vjen Othoni \*. Në Mesolongji bëhet bartja e trupit të Marko Boçarit. Mbreti Othon, i prekur, nxjerr me duart e tij nga kafka e Markos plumbin fatal, por pas pak, ndërsa dëgjon oratorin, që citonte fjalimin e përmortshëm, të përmendë Marko Boçarin dhe heronjtë e tjerë të kryengritjes : "Prijës arvanitas të Greqisë" fytyra i mbushet me habi. Mitropoliti i Artës, Porfirio që e vuri re, godet me inat skeptrin e tij në tokë dhe thotë: "Po madhështi, Shqipëria i ka lindur prijësit e kombit tënd". Othoni që mbeti i shtangur duke u kthyer për nga Kosta Boçari, i dha në mënyrë krejt mekanike, plumbin vdekjeprurës. Porfiri që kujtoi se ai veprim tregonte antipati u kthye nga populli që qe mbledhur aty e thirri i zhgënjer : " Vaj medet Kombit ! Mbreti i tij nuk ia pranon historinë". (Leondios Leondiu, "Çështja shqiptare", 1897 f.45-47)

Që një i huaj, dhe mbret qoftë, të mos njohë historinë e vendit tonë, e keqja është e vogël. Por që të arrijmë 16 vjet pas kryengritjes dhe historia të jetë shtrembëruar aq shumë saqë dhe grekët të mos ta njohin atë, si dhe të përbuzet e të shahet brezi dragua i heronjve të '21, kjo është, të paktën, sakrilegj.

90 nga të 100 heronjtë e Kryengritjes janë arvanitas, por kjo jo vetëm që nuk përmendet nga historianët tanë, por nga njëra anë bëhet një përpjekje që të fshihet ky fakt dhe nga ana tjeter të greqizohet i gjithë populli arvanitas. Po përse ? Mendoj se ia vlen t'i shohim qartë shkaqet e këtij qëndrimi dhe në vazhdim të provojmë me fakte dhe dokumenta ose mashtrimin ose qëllimin e tyre.

Është e vërtetë se arvanitasit flasin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja, në dukje të paktën. Dihet gjithashtu se kur filloi Kryengritja shumë prej tyre kishin përqafuar islamizmin, por ky fakt nuk përbënte

---

\* Mbreti Othon, biri i dytë i mbretit të Bavarisë Ludovik I, u zgjodh nga fuqitë e mëdha si mbret i Greqisë (pak a shumë si Vidi ynë) [sh.p.]

aspak pengesë ose frenim të urrejtjes që dhe ata kishin ndaj turqve. Nga ana tjetër erdhi Falmerajeri \*\*, i cili me teorinë e tij të njohur ngriti intelektualët dhe historikët e shtetit të sapokrijuar. Argumenti më i rëndësishëm me të cilin iu kundërpërgjigjën atij grekët ishte fenomeni i vazhdimësisë së gjuhës greke mes shekujve. Më poshtë do të shpjegojmë pse ky argument nuk ishte i kënaqshëm, por tanë për tanë le të mjaftohemi duke nënvizuar këtë pozitë të vështirë tyren që fillon menjëherë pas këtij argumenti. Dmth. si të ndreqin faktin që pothuajse të gjithë heronjtë e '21, ishin me gjuhë të huaj (shqiptare) dhe që fshatarët e Rumelisë dhe të Moresë në shumicën e tyre dërrmuese flisnin shqip. Disa prej tyre (Surmeli, Ceva, etj.) pretendonin se ata nuk ishin arvanitas por... greke të shqiptarizuar. Ky arsyetim përveç se i gabuar është dhe komik sepse nuk mund të ketë shqiptarizim pa shqiptarë (arvanitas). Keni parë byrek pa brumë? Pamundësia e tyre për të përballuar këtë problem në mënyrë efektive, i udhëhoqi në një seri falsifikimesh dhe temash të tjera që kanë lidhje me çështjen arvanitase. E keqja vazhdon dhe me historianët e rinj, sepse Greqia nuk është më vetëm Rumeli dhe More ose ja dhe Tesali Perëndimore e Epir, që të mund të themi ashtu si Gjergji I, që: "Arvanitasit përbëjnë shumicën e popullsisë tonë". Popullsi të reja hynë gjatë periudhës së krijimit të shtetit grek si dhe pas vitit 1922 dhe përpasojë arvanitasit u shndërruan në pakicë. Këta popuj që erdhën nga lindja dmth. të gjithë të krishterët e Azisë, nuk kanë të bëjnë fare me çështjen arvanitase dhe janë mjaft të gatshëm të vazhdojnë falsifikimin e historisë duke qenë se nuk i lidh asgjë me ta <sup>3</sup>. E njëjtë gjë ndodhi dhe me vlluhët, të cilët që më 1854 zbritën në Rumeli. Këta njerëz e ndjejnë më tepër habinë e Othonit dhe iu është tejësish e padurueshme të thonë se ua kanë borxh arvanitasve lirinë e tyre. Po si t'ia bëjmë? Të shuajmë ngjarjet historike dhe tu vemë heronj të rinj. Makar sikur të na tregonin

\*\* - Teoria e tij do të përmendet në kapitullin përkatës nga autor. [sh.p.]

3 - Flasim për shumicën, duke qenë se dhe në Azinë e Vogël ashtu si në të gjithë Ballkanin, ekzistonin shqiptarë të krishterë që me ngjarjet e '22 \* erdhën në Greqi. Vetëm në Stamboll fundin e shekullit të kaluar ekzistonin 60 000 shqiptarë të krishterë e myslimanë.

\* - Bëhet fjalë për shkëmbimin e popullsisë turke të Greqisë me popullsinë greke të Turqisë më 1922 sipas marrëveshjes dypalëshe ku 1 300 000 banorë erdhën në Greqi dhe 500 000 turq shkuant në Turqi (sipas të dhënave greke) [sh.përkth.]

disa heronj të tyre dhe askush nuk do të kishte kundërshtim t'i festonim dhe ata krahas të tanëve. Por ç'janë perfundimisht këta arvanitas? Ndoshta nuk janë grekë dhe duhet të turpërohem i për lirinë tonë "të dhuruar", apo duhet ta shehim atë thellë deri sa të harrohet, dhe atëherë të qetësojmë ndërgjegjen tonë dhe t'i lemë të kërcëllojnë eshtrat e M. Boçarit, të Xhavelëve, Grivëve, Andrucëve, Mjaulit, Bubullinës, Karaiskaqit, Binjarit, Shkurtanjotit, Plaputit, Kolokotronit, Spiromillës, Djakos, Haxhimëletit dhe të mijëra arvanitasve të tjerë që luftuan për lirinë e këtij vendi. Dhe përmenda vetëm arvanitasit e krishterë. Por ekzistonin dhe arvanitasit myslimanë që duke kapërcyer pikëpamjet fetare, luftuan kundër turqve për një Greqi të lirë dhe pasi morën fillimisht lëvdatat e Ipsilantit, siç u përmend më lart, nga fundi i 1821, zbohen dhe ndiqen pabesisht dhe duke shkelur çdo lloj marrëveshjeje nga ana e grekëve, me rrjedhojë dobësimin e ushtrisë greke dhe nga fitoret e para të lavdishme, të rrezikojë në fund deri në atë pikë, sa të nevojitet ndërhyrja e fuqive të mëdha për të sigruuar mënjanimin e shtypjes së Kryengritjes. Kështu pra, siguruam një Greqi me grekë të krishterë, por të vogël, të pafuqishme dhe të varur prej fuqive të huaja e vendase, të cilat që nga kohë e turkut, zotëronin vendin. Ç'ishin pra këta arvanitas, të cilët krijuan historinë por që nuk e shkruan atë? Ata mbanin Pallën dhe Dyfekun, por disa të tjerë Penën. Dhe ia vlen këtu të përmendim inkurajimin e Karaiskaqit ndaj shkruesit që e shoqëronte në beteja: "Shkruaj Rako, shkruaj, të paktën". Pse, pra, historianët tanë e kthejnë me "gërmë vogla" aleancën fillestare, bashkësinë kombëtare të të gjithë grekëve dhe shqiptarëve, pavarësisht nga Feja? Pse nga njëra anë nuk humbin rast pa i vënë të gjithë të këqiat shqiptarëve, por nga ana tjetër e fshehin farën arvanitase të prijësve të '21? - Pse Shqipëria dhe Greqia janë dy shtete që 40 vjet pas luftës së së dytë botërore ndodhen akoma në gjendje lufte? - Pse dhe kush sabotoi në vazhdimësi themelimin e një shteti shqiptaro-grek? Kush e ndau popullin grek në bazë të bindjeve fetare në një moment kur vetë ky popull vetëm përfanatizëm fetar nuk shquhej, siç do ta vërtetojmë? - Kush dhe si e shpikën termin "turkoshqiptar", ç'kuptim ka, si dhe ku synon? Pse nuk ishte tradhtar Andruçoja, pse e vranë Karaiskaqin dhe cilët e vranë? - Ç'ishin në të vërtetë Suliotët, Bardhuniotët dhe Laliotët? - Është Ali

Pashai ashtu siç na e paraqesin dhe çfarë ishte saktësisht dueli i tij me suliotët? - Përse historianët tanë nuk na i shpjeguan përveç se me gjysëmfjale se ç'janë arvanitasit në përgjithësi? Pse askush prej tyre nuk e përballoi dot Falmerajerin efektivisht? Sa "përgjegjësi" mban ky i fundit për heshtjen e vet dhe për luftën e fshehtë dhe zhurmëmbytur kundër arvanitasve e cila vazhdon deri më sot? Por nga ana tjetër, pse Ipsilantët i konsiderojnë arvanitasit, madje dhe myslimanët, "pasardhës të lavdishëm të paraardhësve tanë"? Përse Ali Pashai vetëquhet "Pirro i Ri" dhe synon të themelojë një shtet të pavarur shqiptaro-grek me gjuhë zyrtare greqishten dhe jozyrtare shqipen. Përse shqiptarët pavarësisht nga feja e tyre konsiderohen dhe kishin bindjen se janë pasardhës të drejtpërdrejtë jo të bizantinëve por të helenëve të lashtë? - Përse dhe europianët, pas nënshtimit të Greqisë nga Muhameti, marrin mercenarët arvanitas si "Estradiotë", nuk i thërrasin asnjëherë arvanitas por as romake ose bizantine, përveç se danë, arë, helenë ose pellazgë? - Pse helenët e lashtë dhe Tukididi, i konsideronin ilirët paraardhësit e shqiptarëve si të afërm dhe të të njëjtit gjak? - Dhe së fundi si shpjegohet fakti që në gjuhën shqipe ruhen fjalë e rrënje fjalësh jo thjesht të greqishtes së lashtë por kryesisht të periudhës para-Homerike, të cilat që nga Lashtësia Klasike kishin dalë në mospërdorim? Përse shumë historianë të huaj si psh. Vernæ dhe Gloxh i njesojnë shqiptarët me grekët, të tjerë i konsiderojnë shqiptarët pasardhës të të menjëherëshëm të pellazgëve<sup>4</sup>, dmth. të atyre që banuan në atë tokë që sot quhet Greqi, gjatë viteve të lashta? - Pse ama, nga ana tjetër historianët e rinj grekë dhe kolegët e tyre shqiptarë përpiken t'i nxjerrin jashtë këta pellazgë dhe të thonë si njëra palë ashtu dhe tjetra se "Pellazgët s'janë grekë", "Pellazgët s'janë shqiptarë"? E kupton tashmë dhe më i padituri se nëse i quajnë pellazgët paraardhës të përbashkët, atëherë automatikisht dëshmohet afërsia e dy popujve. Por këtë gjë synimet e tanishme nuk e duan. Po ja që paraardhësit dhe të grekëve dhe të shqiptarëve rivendikohen që në varret e tyre, ndërsa gërmimet arkeologjike shqetësojnë gjumin e tyre të përjetshëm. Në Shqipëri kohë pas kohe arkeologët zbulojnë sende të lashta dhe ndodh kjo gjë komike. Nxitojnë shqiptarët e thonë: "Ja send

---

4 - Benloew psh.

ilir” dhe pa marrë fryshtë akoma nxitojnë dhe grekët të bërtasin me zemërim: “Po ajo nuk është ilire, por greke”. Dhe sigurisht një pikëpamje logjike mund të ishte dhe kjo që vijon: “Dikush nga të dy duhet të ketë të drejtë, pra tjetri gabon”. Por gjërat nuk janë kështu dhe dikush duhet tu thërrasë kërkimtarëve grindavecë grekë dhe shqiptarë se: “Zotërinj, sendet janë greke pikërisht sepse janë ilire dhe janë ilire pikërisht sepse janë greke. E pësoni këtë konfuzion sepse vetë dogmatizuat që paraardhësit e përbashkët të grekëve dhe ilirëve, dmth. pellazgët duhet të shpallen të huaj për të dyja palët dhe të dalin kështu jashtë fushës tuaj optike studimore”. Lind pra këtu nevoja për të kontrolluar e për të parë se kush janë këta pellazgët, të cilët shumica e kërkimtarëve i do të jenë paraardhësit e përbashkët e të dy vendeve, por që versioni historik zyrtar i të dy vendeve nuk do të ketë asnje lidhje me ta.

Për të provuar identitetin e grekëve dhe shqiptarëve, dhe që shqiptarët kanë lidhje të drejtpërdrejtë jo me bizantinët por me helenët e lashtë, do të përdor si elementë krahasues: 1. Mitologjinë, legjendat greke dhe traditat e të lashtëve. 2. Të dhënrat historike. 3. Doket dhe zakonet. 4. Adhurimin dhe besimet fetare. 5. Gjuhën dhe 6. Krahasimin antropologjik të të dy popujve. Nuk do të përmend “Ndërgjegjen kombëtare” që domosdoshmërisht ekziston deri më sot tek arvanitasit dhe që Kordati e quan element themelor, sepse formimi i ndërgjegjes kombëtare nuk është element objektiv, por rezultat propagande, është dmth. element i fituar dhe jo i sigurt, veçanërisht në rini. Por ia vlen të themi këtu se arbëreshët e Greqisë ishin ata që nga shekulli i XIV kalitën ndërgjegjen kombëtare greke, duke zëvëndësuar kështu, ndërgjegjen fetare që mbizotëronte deri atëherë, në altarin e të cilës u flijua helenizmi i lashtë, sistemi i tij adhurues dhe padyshim civilizimi i tij i papërsëritshëm. Arvanitasit, si trup kryesor i popullit që krijoj Greqinë e Re, e pritshme ishte që të kishin një ndërgjegje të thellë helene dhe jo të fituar e të paqëndrueshme.

## PJESA E PARË

### KAPITULLI I PARË

#### PELLAZGËT

Çelësi për të studiuar dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve historike jo vetëm të Greqisë, por dhe një hapësire më të gjerë territoriale, që përfshin Ballkanin, gadishullin italian, Azinë e vogël me Efksinën dhe Propontiden, Qipron, Kretën dhe bregdetet e Afrikës së Veriut, janë pellazgët. Pikërisht për këtë arsyen shkruan për pellazgët shumë gjëra dhe u hartuan mjaft teori, nga të cilat disa i konsiderojnë ata paraardhës të përbashkët të ilirëve (paraardhësve të lashtë të shqiptarëve) dhe të gjitha fiseve të lashta helene, ndërsa të tjerë i quajnë pellazgët, ilirë të pastër, e të tjera si një nga fiset e shumta që banonin në Greqinë e lashtë dhe rrjedhimisht sipas pikëpamjeve të çdonjërit prej studiuesve përkates, ose fise helene, ose parahelene.

Ideja që ekziston si brenda ashtu edhe jashtë Greqisë, i konsideron pellazgët, parahelenë. Prej këtej rrjedhin mjaft qorrsoke shkencore që kapërcehen me hipoteza, që ndjekin njëra-tjetrën.

Ne do të nisim me shkrimtarët e lashtë helenë dhe me mendimet e tyre mbi pellazgët.

Sigurisht, në fillim, duhet të nënvisojojmë traditat dhe legjendat, sipas të cilave njerëzit e parë, që banonin në vendin që sot quhet Greqi, ishin të ashtuquajturit pellazgë. Dhe Greqia para se të quhej kështu, quhej Pellazgji.

Përpara se të vazhdojmë më tej ne duhet të theksojmë gjithashtu se nga të dhënat e shkrimtarëve, historianëve dhe gjeografëve të lashtë

helenë duhet të veçojmë, ato që ata vetë i përmendin si informacione personash dhe popujsh, si mite ose tradita popullore, nga mendimet dhe përfundimet e tyre vetjake dhe të mos i përziejmë këto kategori me njëra-tjetër.

Legjendat dhe traditat e lashta, pohojnë se njerëzit e parë që banuan Greqinë ishin pellazgët. Greqia quhej më parë Pellazgioti ose Pellazgji dhe banorët e saj pellazgjotë ose pellazgë (shih Herodotin, A 56,57, -B 171, etj.)

Pellazgët jo vetëm në periudhën e klasikëve, por edhe në atë homeriane, përbëjnë një kujtim të largët, legjende dhe tradite. Është e qartë se prania e tyre përmendet në vite shumë të hershme dhe të paekspoloruara nga historia. Aq të largëta, saqë, mosekzistenca e fakteve historike dhe ndryshueshmëria e emrit të tyre nga helenët klasikë dhe të lashtëve paraklasikë, t'u krijojnë dyshime studiuesve të pellazgëve.

Edhe studiuesit e lashtë, ashtu si dhe Homeri me Isiodin, gjenden në mëdyshje, sepse nga njëra anë dëgjojnë traditat popullore të flasin për prejardhje tw helenëve nga pellazgët dhe nga ana tjetër vwnw re se pellazgët nuk mund të janë ata që thotë populli, duke qenë se nuk "ekzistojnë".

Për saktësi, emri pellazg nuk ekziston më, ndërsa vetë si popull ai ekzistonte, por me një emër tjetër (akej, danaj, helenë.), gjë që, sado që legjendat dhe traditat kwmbwgulnin, nuk ishte e lehtë të kuptohej e të vërtetohej.

Le të fillojmë nga traditat, që na ka ruajtur "Kombi pellazg i barabartë me zotin, që mbiu në malet pyjedendur, ose në Tokën e zezë, për të qenë lindësi i të gjithë sojit njerëzor. Shohim këtu se Isiodi, nëse nuk e ka modifikuar traditën që pellazgët janë ata që kanë lindur popullin helen, na përcjell bindjen se pellazgët janë lindësit e të gjithë njerëzimit.

Një traditë e përafërt i tregon pellazgët aq të lashtë, saqë të kenë lindur përpara Hënës dhe për këtë arsyë i quajnë ata Parahënës ose Parahënas\*.

Shiko ps. Herodotin fq. 56, 57, 146, 171, ...95, 773.  
Mite-legjenda-tradita

\*Në greqisht; (c) àç ose; (c)....(Porselines ose Porselanes) selini - hëna në tipin dorian thuhet; (Selana)

Si popull më i lashtë i Greqisë përmenden arkadet që sipas hipotezash të cilat i them i rezervuar, ishte populli që shpëtoi nga një përblyje katastrofike, që kaloi në traditat helene si “Përblyja e Defklionës”. Është e logjikshme që banorët e Arkadisë malësore të largoheshin prej krahinës pas një përblyjeje të tillë.

Si mbret i popullit të lashtë arkadian nga mitet, përmendet të ishtë Pellazgu, i cili nuk mund të jetë bir njeriu, por perëndie. Është pra, Pellazgu biri i Perëndisë dhe i Tokës (i babait Diell dhe i nënës Tokë.)

Shumë më vonë Herodoti do të na ruajë një traditë tjeter, sipas së cilës, në kohët e vjetra e gjithe Greqia quhej Pellazgi. (II, 56) Por Herodoti do të humbasë fillin në çështjen e pellazgëve, sepse nga njera anë zë në gojë traditat popullore, në përputhje me të cilat, janë pellazge, athinejtë janë pellazgë (VII 95), eolët janë pellazgë (II, 171) edhe dodonët janë pellazgë, por i krijojnë probleme disa gjëra që do t'i shohim më poshtë. Thotë dhe diçka akoma më të përgjithshme dhe më të rëndësishme, ose që të jemi më të saktë, na përciell një bindje të rëndësishme popullore, në përputhje me të cilën, i gjithë kombi grek, nuk është veçse një pjesë e kombit prllazg (I, 58). Poeti i madh tragjik i lashtësisë, Eskili, në “ia” (Lutësit) përcjell edhe ai traditën e vjetër greke, sipas së cilës, në vitet e lashtësisë “Grekët ishin të bashkurar në një shtet të vetëm që fillonte që nga Peloponezi dhe arrinte deri në Iliri: “Fëmijë i atij që jetoi në këtë vend, jam unë, Pellazgu, kryetari i këtij vendi dhe që prej meje mori emrin kombi i pellazgëve, që korr këtë tokë, nga ku kalon i papërshkueshmi Struma. Shteti im shtrihet deri në vendën e perebëve përtëj Pindit dhe vendit të peonëve dhe maleve të Dodonës. Arrijnë madje kufijtë e tij deri në të lagështin Det. Te të gjithë këto kam pushtet.”

Këtu Eskili përpinqet të verë në dukje që grekët që nga vitet e hershme ishin të bashkuar, në vazhdim u shpërbënë ndaj me sa duket, ai bën thirrje për bashkim.-

Homeri e përmend Taselinë si “Fushë pellazg” dhe tesalët i quan panhelenë. Njëkohësisht quan Perëndinë (Dias), me anë të Akilit “Dodon pellazg” si dhe lutjen e Akilit te Perëndia Dodon si lutjen ndaj Zotit më të madh stërgjyshor. Megjithatë vetë Homeri, zë në gojë si aleatë të trojanëve, një popull të Trakës që e quan pellazg. Ç’ bëhet?

Si është e mundur të quhet Pellazgji; Peloponezi, Epiri dhe Tesalia, Dilo dhe Lesbo dhe e gjithë Greqia, si është e mundur të quhet pellazgë i të gjithë helenët e lashtë dhe në të njëjtën kohë të quaj pellazgë aleatët e Trojanëve, një popull të Trakës? Si është e mundur të konsiderojë grekët pellazgë dhe nga ana tjetër të nxjerrë përfundimin vetiak se pellazgë nuk ishin grekët, por barbarët (të huajt), siç do ta shohim me habi më poshtë? Dhe si, disa historian të sotëm duke mos marrë fare parasysh traditat, që na përciell Herodoti, por të mbështetur vetëm në konkluzionet e tij, shfaqin edhe ata mendimin se pellazgët nuk ishin helene...parahelenë, pra e njëjtë gjë?

Që t'i gjejmë anën kësaj ngatërrese dhe të nxjerrim përfundime të sakta, duhet të bëjmë ndarjen e shkrimeve të Herodotit në menyrë që të shohim se cilat nga ato që paraqet janë tradita popullore, cilat mendime dhe cilat konkluzione të tij, gjëra këto që dhe vetë Herodoti ka ndjeshmërinë t'i ndajë.

Do të detyrohem i rikujtojmë informacionet e tij sipas të cilave jonët, eolet, aret, etj. ishin pellazgë. Ai emëron kombin e jonëve pellazg dhe të dorëve helen, por në vazhdim thotë se dorët ishin në fillimet e tyre “të dobët dhe bredharakë dhe u shkëputën herët nga pellazgët, cilëve (pellazgët) u përkisnin dhe jonët”. D.m.th. nuk lë fis helen pa orgjinë pellazge. Mirëpo ç'përfundim nxjerr ai, që mund ta nxjerrim edhe ne nga ato që parashtruam?

“Se ç’ gjuhë flisnin pellazgët, nuk mund ta themi me siguri. Por nëse më duhet të them mendimin tim, i bazuar në pellazgët që akoma dhe sot jetojnë... në qytetin Kristona...Plakia... dhe Skilaki...pellazgët flisnin barbarisht. Nëse kjo vlen për të gjithë pellazgët, si psh. kombi i Atikës, që ishte pellazg, po përderisa u kthye në helen, ndërroi gjuhën e tij, atëherë mund të themi se kombi helen, që kurse u shfaq (në tokë) ka folur të njëjtën gjuhë - kjo është bindja ime (!). Më tej, kur u shkëput nga pellazgët, fillimisht që i dobët dhe i vogël në numër, më vonë u shumua e u shumëzua në kombe, siç bënë edhe pellazgët dhe shumë fise të tjera barbare. Së fundi jam i mendimit se kombi pellazg, ashtu si dhe më përpala dhe përderisa ishte barbar, nuk njoihu asnjëherë pushtet të madh”. (Dh. N. Maroniti, I. 57, 58)

Secili prej jush e kuhton tashmi se Herodoti është penguar nga bindja e tij e gabuar (të cilën dhe e shprehu) se helenët që kur u shfaqën

në tokë flasin të njëjtën gjuhë dhe në faktin, se në kohën e tij, kombi me emrin “helenë”, ka qenë gjithnjë populli që ai përshkruan.

Duke patur si parim bindjen e tij që gjuha e një populli nuk ndryshon (“Kombi helen që kur u shfaq, flet gjithnjë të njëjtën gjuhë, kjo është bindja ime) si dhe bindjen mjaft të përhapur aso kohe se kriter i helenizimit ishte gjuha, ai vë në mëdyshje traditat popullore dhe përpinqet t'i studiojë, sipas një parimi të gabuar, me pasojë që të rreshtojnë një seri konkluzionesh po njëlloj të gabuara. Ndaj thekson se kombi helen u shkëput nga pellazgët, në vazhdim thotë se helenëve iu shtuan edhe pellazgët bashkë me disa fise barbare. Kush janë këto fise që nuk na i emerton?

Kombin atikas e quan pellazg, por gjithashtu shton se u kthye në helen dhe ndërroi gjuhën e tij. Por njëkohësisht ka thënë se helenët janë pjesë e pellazgëve, se ata flisnin të njëjtën gjuhë, etj. etj. Megjithatë kjo nuk është dhe kaq shumë e ngatërruar siç duket dhe siç i dukej Herodotit.

Në Athinë ekzistonin të ashtuquajtura “Atika” dmth. kronika historike të Athinës dhe Atikës, që fatkeqësisht nuk kanë shpëtuar, por në to përmendej orgjina pellazge e athinejve. Muri më i vjetër i Akropolit quhej “pellazgjik”. Por, Herodoti, që kaq shumë i adhuronte athinejtë për forcën, burrërinë dhe urtësinë e tyre, ishte e pakonceptueshme t'i njehësoje ata me “pellazgët” e Plakisë, të Skilakit, të Kristones në Itali që flisnin një gjuhë barbare, siç konsaton dhe ai vetë!

Të gjitha këto kishin rrënjosur bindjen se pellazgët nuk mund të ishin vetë helenët në zhvillimin e tyre, ashtu si nuk arrijnë të kuptojnë studiuesit e sotëm se arvanitasit analfabetë të shek. të XIV ose të XVIII të kenë lidhje me Homerin, Perikliun, Epaminonden ose Themistokliun. Por Platon i urtë kishte domosdomërisht dyshimet e tij mbi konkluzionet e Herodotit, sepse dëgjojmë tek “Kratilo” e tij të thotë: “Çdo gjë që ne sot nuk e kuptojmë dhe nuk nuk e njohim në gjuhë, ka të ngjarë të jetë Barbare, por ka të ngjarë të jetë e të duket e tillë për shkak të vjetërsisë”. Dmth. me fjalë të tjera, Platon i vë re këtu fenomenin e zhvillimit te gjuhës ose vendos menjëherë një rregull themelor të shkencës së gjuhësisë.

Herodoti duke e injoruar këtë rregull dhe i bindur se gjuha nuk shndërrohet, nxori përfundime të gabuara, por njëkohësisht parashtoi

edhe traditat popullore në mënyrë që ne tani të gjendemi në pozita më të favorshme se ai vetë, për sa i përket nxjerrjes së konkluzioneve mbi të njëjtat gjëra.

Pellazgët, siç do ta shohim më poshtë, u vendosën në një hapësirë që fillon me gadishullin italian, kalon në Ballkan, në Azinë e Vogël dhe përfundon me bregdetin e Afrikës së Veriut. Shekuj pas vendosjes së tyre fillestare, është mjaft logjike dhe e natyrshme, që gjuha e pellazgëve të Italisë me gjuhën e pellazgëve të Greqisë, të Trakës, të Azisë së Vogël, ose të Afrikës veriore, të ketë pësuar dallime. Po nëse do të ekzistonin pellazgë të ndarë në mes nga popuj të tjera, ata do të arrinin ta ruanin gjuhën e tyre tradicionale, ndërsa pellazgët që do të qendronin në orgjinën nga emigruan të tjera, jo vetëm do ta ruanin dhe do ta flisnin këtë gjuhë, por do të ruanin dhe gjithçka tjetër. Sot shqiptarët ruajnë trupin themelor të kësaj gjuhe të vjetër pellazge, siç do ta shohim më poshtë. Pamë se Herodoti, me kritere të vërtetuara në mënyrë të gabuar, quan "barbar" pellazgët, pamë akoma se traditat popullore i tregojnë si lindës të helenëve.

Dionis Alikarnasevi, duke patur parasysh jo vetëm traditat, të cilat me siguri duhet të ishin pakësuar në kohën e tij, por edhe në kohën e shkrimtarëve para tij (Herodoti, Tukididi, etj.) nxjerr një përfundim të vetin: "Janë pra edhe pellazgët një komb helen", sipas të cilit sheh që nuk mund t'i konsideroje pellazgët si një nga fiset e shumta helene. Por nëse do të ishte kështu, atëherë kjo do të qe e pamundur, siç konkludonte dhe Herodoti.

Por si është e mundur të jetë dhe të konsiderohet e pamundur dhe njëkohësisht të quhet lindës i helenëve dhe banues i territoreve helene deri atëherë të njohura.

Siç përmend gjeografi i madh i lashtësisë Stravoni: "Pellazgët ishin fise të lashta që u vendosën në Greqi dhe përveç Eolisë dhe Thesalisë... ata banuan edhe në Kretë, siç thotë dhe Homeri... dhe në Fushën Pellazge, që quhet Tesali... të tjerë thonë që dhe kombet epirote janë pellazge... Diellin (perëndinë) Dodon, ky poet (Homeri) e quan pellazg... dhe Lesbon Efori e konsideron pellazg; Madje, Antiklidhi shton se edhe Limno dhe Imbro u banuan nga pellazgë, ashtu siç u banuan dhe Torino me Avian në Itali, ndërkohë që dhe shumëshkrimtarë atikas flasin për pellazgë të lindur në Athinë..."

Me sa shohim, Stravoni paraqet përveç traditave popullore dhe përshtypje të shkrimtarëve të mëparshëm, si psh. Efori Antiklidhi dhe të atyre që shkruan "Atikat" e famshme, por dhe ky nuk mund të hedh dritë mbi misterin e pellazgëve.

Por le të kthehem i idenë e Dionisit të Alikarnases që i emëron pellazgët, komb helen dhe te Herodoti që e quan këtë gjë të pamundur. Përtej përshtypjes së Stravonit, që është gjeograf, kemi dhe gërmimet arkeologjike si dhe emërtimet pellazgjike që fillojnë nga Iliria dhe Italia, kalojnë nga Greqia, nga Azia e Vogël dhe arrijnë në ishujt e Afrikës Veriore. Si është e mundur atëherë të konsiderohet i pamundur një komb i tillë ose në se është një nga kombet e shumta greke dhe madje ai që i dha gjuhën, shkrimin, idhujt dhe zotat, atëherë...Ja pra, si krijohet çështja e famshme pellazge që bëri t'u dhëmb koka të gjithë kërkuesve, nga lashtësia deri më sot.

Çështja u krijua, jo aq pëe mungesë faktesh, sesa për mungesën e një përbledhje të saktë.

Faktet janë: 1) traditat e lashta greke ashtu si na i tregojnë shkrimtarët e lashtë, pa përfundimet e tyre. 2) elementët e gjuhës shqipe që fatmirësisht flitet dhe sot dhe 3) rezultatet e gërmimeve arkeologjike.

Ata që nuk iquajnë helenë pellazgët, përveç traditave të lashta helene, padyshim injorojnë edhe ghuhën shqipe, thelbësisht injorojnë edhe pellazgjishten.

Aq më tepër që ekzistojnë dhe kërkues të sotëm shqiptarë, që në kundërshtim me paraardhësit e tyre të shek. XVIII dhe XIX, shfaqin, mendimin se pellazgët nuk janë paraardhës të përbashkët të ilirëve dhe helenëve, siç thotë Tukididi, megjithatë një version i tillë i thënë për ata të cilët mjaft historianë i konsiderojnë paraardhës të vetëm dhe të drejtpërdrejtë të pellazgëve, tregon më tepër interes politik dhe qëllime nacionaliste se sa një përpjekje studimore.

Elementët që iu hapën telashe kërkuesve të lashtë e të rinj janë: 1) Ndryshimi i gjuhës, që e përcaktoi dhe Herodoti, 2) zhdukja e emrit "pellazg" që nga koha e Homerit dhe 3) mosekzistenca një qytetërimi zyrtar pellazg (dmth. që të provojë ekzistencën e tij me shkrim, zbulime arkeologjike dhe metoda të tjera. (sh.p) përveç pohimeve tradicionale popullore që i kundërvihen njeri-tjetrit.

Tek elementi i parë, përgjigjemi se nuk bëhet fjalë për gjuhë të ndryshme, siç besohet në mënyrë të gabuar, por për vetë gjuhën greke në fillimet e saj. Apo, ndryshe, dialekti i Homerit dhe i Atikës, nuk janë veçse zhvillimi natyror i gjuhës së lashtë të pellazgëve gjë qe do të na jepet rasti ta vëmë re në vazdim të këtij studimi. Nga momenti që pellazgët janë vendosur në një teritor që nga Italia e deri ne Azinë e Vogël dhe Afrikën e Veriut, pasojë është dhe diçka e thjeshtë: 1) modifikimi sipas vendeve i gjuhës së tyre të vjetër e të përbashkët dhe 2) ritmet e ndryshme të qytetërimeve në përshtatje me këto vende. Në Plaki dhe Skilaki në periudhën e Herodotit, dmth. shumë shekuj pas epopesë së madhe emigruese pellazge, flitej pellazgisht, edhe pse në një dialekt të saj, që me sy të parë nuk kishte asnjë lidhje me pellazgishten e Athinejve, të cilën grekët e quanin dialekt të Atikës.

Përsa i përket elementit të dytë, nuk kemi zhdukje as të pellazgëve, as të emrit kombëtar "pellazg", por zëvëndësimin e tij më përpara me emrin "Akej", "danaj". Një copëtim pra në fise i kombit pellazg (sepse i tillë ishte ndërtimi i tyre shoqëror, në qytet- shtete) dhe lindja kështu e popujve helenë në arë, mirmidë, helenë, minej, flegë, kademianë, etj. Në vazhdim kemi një bashkim që fillon me forcimin e dorëve ne jug, në dorë, jonë dhe eolë dhe së fundi emrin përgjithësues helenë. Çështja e ndërrimit të emrit të një populli, që kalon pa u vënë re nga studiush e çështjes pellazge, është një fenomen mjaft i zakonshëm në historinë e popujve.

Veçanërisht helenët e lashtë dhe shqiptarët e shekullit të kaluar e kishin të ndërtuar shoqërinë e tyre në fara, të cilat megjithëse, ishin të ndërgjegjshëm për orgjinën e tyre të përbashkët gjendeshin në situata lufte.

Prijësi i çdo fisi mund të bëhej edhe emërdhënësi i tij, ose duke e zgjeruar ndikimin e tij edhe te fiset e aférme të bëhej emërdhënës i dy, tre, dhe më shumë fisesh.

Akejtë e Peloponezit, përveç faktit se ishin fillimisht një popull i vogël i gadishullit, iu dhanë emrin e tyre të gjithë ushtarëve që përdorën kundër Trojës.

Greqia dhe helenët e morën këtë emër rrëth shekujve VII-VIII p.e.re. dhe do të shohim në kapitullin përkatës se Homeri nuk i quan asnjëherë helenë apo vendin Hellas të ushtarëve që luftuan kundër Trojës.

Greqia dhe helenët e morën këtë emër rrreth shekujve VII-VIII p.e.s.dhe do të shohim në kapitullin përkatës se homeri nuk i quan asnjëherë helenë apo vendën Hellas të ushtarëve që luftuan kundër Trojës.

Helenët dhe Greqia përmenden një ose dy herë nga Homeri si një vend i vogël në rrëzë të Pindit, ku dy gjërat më karakteristike janë se ndodhet nën pushtetin e Akilit dhe se ka gra të bukura. Me tërë këto kemi në vitet e më passhme “zhdukjen” e akejve dhe danajve dhe mbizotërimin e helenëve. Dmth. ky popull i vogël që nuk shquhej për burrat, por për gratë e bukura, u bë emërdhënësi i të gjitha këtyreve fiseve, kur ndërkohë kemi zhdukjen e të lashtëve dhe sundimin e helenëve, askush nuk guxon të thotë që helenët ishin popull i ndryshëm nga të lashtët e Trojës, ndërsa lidhja e këtyre të fundit me helenët ruhet në legjendat dhe traditat. Po pyes, a e shkruajmë historinë duke na prirë ndjenjat apo ndonjë interes tjetër?

Sigurisht, akejtë lidhen me helenët e mëvonshëm dhe do ta provojmë më poshtë me fakte dhe përbledhje, shumë më të ndryshme nga ato që kemi njojur deri më sot.

Që të kthehem tek çështja e ndërrimit të emrave kombëtarë të popujve, do të përmendim një fragment nga “Kryekompania” e Euripidit që na e ka ruajtur Stravoni: Thotë Euripidi, se kur Danau erdhi në Argos, banorët, që më parë quheni “pellazgë”, sipas ligjit etik do të quhen danaj” (V;220). Pra, kemi këtu një ndryshim tipik të emrit të një populli si dhe një shembull “zhdukje” - zëvendësimi i emrit kombëtar “pellazg” nga emri i ri danaj. Por kjo siç e kuptioni nuk do të thotë zhdukje e kësaj pjese të popullit pellazg...

Përveç Greqisë që ka ndërruar disa herë emrin e sot e kësaj dite quhet nga grekët “Hellas” dhe nga europianët “Greece”, nga turqit “Junanistan”, etj., edhe shumë popuj të tjerë e kanë ndryshuar emrin dhe kjo në asnjë rast nuk tregon asimilim ose zhdukjen e ndonjërit prej tyre. Persia quhet ndryshtë Iran. Shqiptarët sot me të njëjtin emër (nga europianët, albanë) quheni para disa vitesh arbëreshë, më përpara, ilirë dhe shumë më përpara sigurisht pellazgë. Por mbetën gjithnjë i njëjtë popull. Duke qënë se pellazgët, helenët e lashtë dhe arbëreshët janë i njëjti popull, por në fazë të ndryshme të zhvillimit të tij dhe meqënëse një nga karakteristikat e tij është shoqëria e ndërtuar sipas tipit klan-fis,

do të mar si shembull të ndryshimit një fis të madh arbëresh, fisin e Buejve që, ndërsa sundonte në Greqi e Italinë qendrore për 6 shekuj, tashmë e ndeshim mjaft rrallë mbiemrin Bue. Ç’u bë ky fis sundues dhe popullsia e tij e madhe?

Një përbledhje e sipërfaqshme do të na conte në përfundimin e gabuar se u zhduk. Këtë mbështet dhe Biri tek “Arvanitasit- dorë të neohelenizimit”. Por fisi i Buejve nuk u zhduk, ai thjesht ndërroi emër siç ndodhi me pellazgët”.

Njësoj me helenët e lashtë, arbëreshët që shquheshin për fuqinë dhe forcën e tyre, shkëputeshin nga fiset dhe formonin fis të tyre, në kuptimin që bëheshin në mënyrë të padrejtë kryetarë fisesh, dmth. duke mos qënë të tillë fillimisht, apo i vinin emrin e tyre të gjithë fisit. Kështu që Buej ishin Kladet e Moresë, që nxorën të madhin Klad Krokondilin. Këtu Kladi sillet si emërdhënës i brezit të mëpasshëm të Buejve dhe për saktësi të një pjese të saj.

Buej ishin dhe Shpatat. Bue Shpata u bë emërdhënësi i brezit pas tij.

Buej ishin dhe Grivejt. Një Bue Griva u bë emërdhënës i brezit të tij. Bue Mërkuri u bë emërdhënës i fisit të Mërkurëve. Bue Murriku i dha emrin Murrikëve, etj.

Tashmë fisi i Buejve në Greqi, Itali dhe Shqipëri, ndoshta nuk ekiston, por Kladët, Grivejtë, Mërkurët, Murrikët, ashtu si helenët e lashtë e ruajnë kujtimin e prejardhjes së tyre të përbashkët nga fisi i i madh i pellazgëve (më falni, i Buejve).

Në kapitujt që vijojnë do ta trajtojmë më mirë pretendimin tonë se, pellazgët nuk u zhdukën, nuk ishin parahelenë, por ishin fis helen në kulmin e shpërthimit të tij biologjik, që duke u nisur nga malet e Shqipërisë, banoi me një epos të papërsëritshëm emigrues Italinë Qendrore dhe Sicilinë, Greqinë dhe Azinë e Vogël dhe Afrikën veriore. E pra, pikërisht në këto vende, ku që nga vitet e lashtësisë e deri më sot ne ndeshemui me helenizimin.

Çështja që do të diskutojmë është se si ta pranojmë këtë pikëpamje (dhe nuk mendoj të qëndrojë ndonjë e kundërt) sipas ssipas së cilës shqiptarët dalin grekët më autentikë e duke qënë se pellazgët vërtetohen si parardhës të përbashkët të shqiptarëve dhe helenëve, atëherë nuk ka arsyë të krijohet një urrejtje e tillë e pabazë midis të dy popujve që këtu

e 40 vjet gjenden në situatë tipike lufte. Them që shqiptarët vërtetohen si grekët më autentikë, sepse përveç pjesës kryesore të gjuhës pellazge që ruan sot gjuha shqipe, ekzistojnë dhe rezultatet e kërkimeve antropologjike, të dokeve, të zakoneve, të karakterit dhe përgjithësisht të botëkuptimit, që ka një përputhje të plotë me helenin paraklasik ose me dorët e mëvonshëm.

Elementët që dallojnë shqiptarët nga helenët e periudhës klasike janë: 1) shkalla kulturore që arsyetohet nëse marrim parasysh faktin që shqiptarët ishin të detyruar për shekuj me radhë të jetonin në male me armë në dorë që të ruanin parimet e tyre të trashëguara të lirisë, krenarisë, mosbindjes dhe të pastërtisë së racës deri në ditët e sotmës dhe 2) gjuha që nuk është gjë tjeter përveç gjuhës së lashtë pellazge, siç theksojnë mjaft kërkues gegë e të huaj të kohërave të reja. Për gjuhën thamë pak gjëra, por do të na jepet rasti që t'a zbulojmë më mirë në kapitujt që vijojnë.

E për të bërë një ndërthurje do të përmendim se çështja e gjuhës së shqiptarëve shqetësoi mjaft kërkues të sotëm grekë që me keqardhje shihnin se heronjtë e viteve '21, "nuk flasin greqisht, por shqipen barbare", dmth. pësuan atë që pësoi edhe Herodoti, kur dëgjoi pellazgisht në Plaki dhe Skilaki të Elispondit (Dardaneleve), ndaj dhe iu ishte e pakonceptueshme të shtronin hipotezën se dialekti Atikas dhe athinejtë delikatë kishin ndonjë lidhje me pellazgët dhe me gjuhën e tyre. Kështu, ndërsa detyrohen të parashtrojë traditën athinase sipas të cilës athinejtë kanë prejardhje pellazge, thonë se ata edhe sikur të vijnë nga pellazgët, përderisa mësuan greqisht u kthyen në helenë.

Këto pikëpamje për gjuhën ekzistonin dhe në lashtësi bashkë me grindjet e stërgjyshërve tanë të urtë: Herodoti i konsideron Molosët dhe Dhesprotët "helenë", kurse Tukidi i quan "barbarë". Nga këto vlerësime të shkrimitarëve të lashtë, kanë rrjedhur dhe divergjencat midis grekëve dhe shqiptarëve.

Kështu disa nga njera anë i referohen Herodotit që të provojnë se Molsia dhe Dhesprotia janë grekë, nga ana tjeter të tjerët sipas Tukididit, pohojnë se këto vende janë shqiptare. Të tjerë përpiken të provojnë se ka të drejtë Herodoti, të tjerët për Platonin ose Stravonin, ose Tukididin.

Dhe ndërkohë që kërkuesit grekë e shqiptarë përdorin shkrimitarët e lashtë në grindjet e tyre dhe kërkojnë fakte të dallimit midis të dy

popujve, askush nuk mendon se përse duhet të ekzistojnë dallime mbi kombësitë e të dy popujve, por karen pas versionit të atyre shkrimtarëve që iu interesojnë.

Për mua problemi i vërtetë nuk është se kush shkrimtarë ka të drejtë, por pse dhe nga ç' shkaqë rrodi ky dallim i vlerësimeve të tyre. Me fjalë të tjera as që bëhet fjalë që unë t'u tregoj në ka drejtë Herodoti apo Tukididi, por të inkuadroj përqendrimin mbi një temë a një problem, për zgjidhjen e të cilët do të arrijmë në zbulimin e së vërtetës në lidhje me Dhesprotët, Molosët, Haonët, Atamanët dhe popujt që i rrëthonin të cilët të lashtët i quanin "barbarë" e të tjerë "helenë". Problemi për tu zgjidhur është: Për ç' arsyen shkrimtarët e lashtë dallojnë në mendimet e tyre mbi kombësinë e këtyre popujve?

Përmendëm më lart se Platon te "Kratilo" na thotë se një gjuhë që nuk e kuuptojmë, mund të jetë barbare, por mund të duket e tillë dhe të mos jetë. Dmth. të jetë gjuha e lashtë e stërgjyshërve tanë. Mendoni si do dëgjohej sot gjuha e Homerit? Pak a shumë si kinezë. "Barbarë" helenët quanin jo vetëm të huajin, por edhe ata që nuk i shqiptonin mirë fjalët. Isihio, që formoi një fjalor dhe shpëtoi kështu disa fjalë të rralla, që Jakov Thomopulo i analizoi dhe tregoi që janë të njëjta me shqipen e sotme<sup>1</sup>, pohon se "Barbarofonët ile dhe kare, flisnin me pak rrokje dhe të paqartë në shprehje".

Pra thesprotët, molosët, haonët dhe atamanët duhet të kenë qenë zëtrashë dhe dialekti i tyre duhet të dallonte shumë nga dialekti atikas.

Por ja që gjeografi i madh i lashtësisë Stravoni na ka ruajtur një fjalë molose, "Pelia" që do të thotë "Plak". Pelia quheshin dhe shenjtorët e Orakullit të Dodonës dhe sigurisht që duhet të ishin pleq. Pra, molosët flisnin shqip që atëherë e deri në shek. XIX, e faktikisht dhe sot. Një gjuhë dmth. që Tukididi athinas e imagjinonte barbare. Të njëjtën gjë pësuan dhe historianët e sotëm që konsideruan të huaj gjuhën shqipe.

Në Qipro haset fjalë "mastos" = "gotë", në shqip "mashtrape". Në Lakoni fjalë "vagaron", d.m.th. fillon të ziejë, nga shqipja i vakur, (i vakët) bëhet i vakur. Fjalë "grifaste" = "gërvisht". Gjithashtu "dhiza" = "kec", nga përshtatja "dhiez", d.m.th. dhi e vogël.

---

1- Në Kretë psh. haset fjalë "ietas" = baba, në shqip, "i ati".

dhif-ura = ure, aeya - (ekso-vadhia) nga fjala vathë.

Në Maqedoni, (të merret si krahinë greke që përfshin edhe qytetin e Selanikut dhe jo shtetin maqedon që sipas grekëve ka marrë emrin nga kjo krahinë e Greqisë dhe u bë tema për grindjet midis dy shteteve kohët e fundit shën. i përkth.) haset midis të tjerave dhe kjo fjale “vathara”, që do të thotë vatra (vatër).

Shënova disa nga ato, që parashtron Thomopulo në librin “Pellazgjishtja”, të marrë nga fjalori i Hisios dhe nga krahinat e Kretës, Maqedonisë, Lakonisë dhe Qipros.

Gjuhët e lashta ishin me pak rrokje dhe përbanin shumë bashkëtingëllore. Ndërhyrja e zanoreve ishte shpikje e popujve të civilizuar.

Helenët dhe athinejtë ishin të parët që zbuluan nacionin e së bukurës dhe të harmonisë, dhe do të ishte e pakutueshme të mos merrnin në konsideratë bukurinë e gjuhës. Përderisa krijuan fjale të reja që të shprehnin kuptime dhe veprime të reja (tregti, detari, teatër, letërsi, filozofi) duke qënë se nga fjalori i kufizuar pellazg, zhvilluan një fjalor më të pasur nga sa ka për të treguar përceptimi njerëzor, me krijimtarinë gjuhësore dhe futjen e zanoreve, e pritshme ishte që me kalimin e kohës ashtu si dhe Tukididi të mos ta kuptionin variantin e vjerër të stërgjyshërvë të tyre dhe ta quanin atë “barbar”.

Por Platon i ditur që kishte udhëtuar në shumë vende të tjera, kishte kundërshtimet e veta kur shihte se përtej gjuhës ekzistonin elemente të tjerë të përbashkëta dhe se gjuha nuk mund të konsiderohet si fakt i vetëm dallues midis dy popujve nqs. nuk saktësohet se këto dy gjuhë midis tyre janë krejtësisht të ndyshme dhe nuk përbëjnë zhvillim të njera tjetrës, siç ndodh me pellazgishten dhe greqishten.

Siç thamë, gjuhët e vjetra përdorin shumë bashkëtingëllore, në shumicën e rasteve dhe përdorimi i zanoreve tregon zhvillim kulturor. Në të vërtetë, akeologët që zbuluan një mbishkrim në Karatepe e interpretuan fjalën Mps në Mopso dhe shumë drejt.

Fjala Mps duket tërësisht e pakuptueshme, por nqs. e shqiptoni duke futur zanoret në mes, do të dalë Mopso. Dhe Mopso ishte mbreti dhe themeluesi i vendbanimeve në Kilkia. Në të njëjtën mënyrë del dhe Pelia nga fjala Plak duke futur zanoren pas “p” dhe “l”.

## LIDHJET E PELLAZGËVE ME FISET E NJOHURA HELENE

Do të vazhdojmë të parashtrojmë traditat, ashtu si na i paraqet Herodoti, të atyre traditave në bazë të të cilave, në periudhën e lashtësisë, fisi i joneve konsiderohej si pellazgjik dhe dorët si helenë.

Por dhe fisi i dorëve që kurse u shkëput nga kombi pellazg ashtu si dhe jonët para tyre, ishte fillimisht, i pafuqishëm dhe endacak.

Përsa i përket fisit të tretë të madh helen eolëve, edhe ata sipas informacioneve që kishte Herodoti, ishin pellazgë. Pra, përfundimisht dhe në mënyrë të përgjithshme ai përmend se i gjithë fisi helen u shkëput nga pellazgët, pjesë e të cilit qe më parë. (Herodoti: I 57,58, 146-II, 171-VII, 95 VIII 73).

Pamë gjithashtu se përveç pohimeve, Herodoti përderisa besonte në mënyrë aksiomatike se gjuha nuk shndërrohet dhe se grekët kanë folur të njëjtën gjuhë, duke patur parasysh dhe gjuhën që degjoi në Elispond ai nxjerr përfundimin se pellazgët ishin barbar.

Përfundime sigurisht të gabuara, por në të cilat mbeshteten sot disa historianë të rinj për të ndarë grekët nga pellazgët.

Ata pohojnë se periudha që kur helenët jetuan në Greqi, fillon me epokën e akejve, për të cilët madje kemi dhe mjaft informacione si nga Homeri ashtu dhe nga zbulimet arkeologjike. Disa pranojnë se ekzistonte një popull i mëparshëm që quhej "paraakej", i cili nuk përmenden asgjëkundi dhe si rrjedhim duhet të jenë sajesë e tyre. E pellazgët nuk i quajnë helenë por parahelenë

Meqënëse nuk eshte e mundur të referohem tek të gjitha variantet e ngjajshme me këto, do të kem parasysh historianin e madh helen Kordatin dhe një kërkues të kohëve te sotme Profesor Mihal Saqelariun.

Në kundërshtim me kërkuesit që përmendëm dy paragrafe më lart, unë këmbëngul tek pellazgët sepse shoh vulën e tyre në të gjitha fazat e realitetit helen, aq më tepër që s'kam dëgjuar ndokund për paraakej. Për mua këta nuk janë gjë tjetër veçse pellazgët, ashtu si dhe akejtë,

vetëm se këta të fundit zhvilluan një qytetërim dhe bënë një orvatje (Fushata e Trojës) për të cilën u gjend një poet i madh (Homeri) që të na e rrëfejë.

Pellazgët kanë zhvilluar fushata të pafundme, në Itali, Sicili, Egjipt, Azi të Vogël dhe Qipro, por në kohëra të cilave nuk u ka interesuar t'i shkruanin e t'i bënин histori. Mbeten, pra, legjendat dhe traditat si dhe këngët, kështu siç do të mbesnin deri më sot, nqs. nuk do të gjendeshin historianët të tregojnë për betejat e mëdha të Ali Pashës dhe suliotëve ose- që të kthehem i më prapa- askush prej nesh nuk do të dinte se si në Termopile Leonidha shpartalloi persët me 300 spartanë, nëse do të prisnim vetë spartanët të na e tregonin ngjarjet!

Fushata detare e Argos që ka ndodhur para asaj të Trojës, pasqyron një orvatje të helenëve ashtu si dhe ato që bënë shekuj më parë e më pas.

Flasim gjithnjë për të njëtin popull dhe kjo nuk dëshmohet vetëm nga gjuha, por dhe nga zakonet, doket, idhujt, besimet fetare dhe karakteri.

Në veri ekziston një rezervat që fillonte nga Epiri dhe arrinte në brigjet e Danubit. Këta helenë kohë pas kohe rionin hemoragjinë e grekëve të jugut duke ardhur herë si dorë, herë si arvanitas, herë si persona (Tiseu, Kademi, Atamani, Buti, Falari) e herë si fise (suliotët, leberit, kipselet) etj. Nuk ekziston në legjendat dhe traditat e popullit helen, ndonjë përlleshje e akejve ose e paraakejve me pellazgët, me qëllim që këta të fundit të largoheshin nga Greqia.

As ndonjë pushtim i akejve nuk përmendet. Por unë për hatër të atyre që mbështesin të kundërtën pranoj për momentin, të dy këto versoine si të mundshme.

Po ateherë kush asimiloi dhe kë, paraardhes të kujt mburremi se jemi, duke qënë se gjuhën, fenë, idhujt, zotat, artektonikën etj. na i lanë trashëgim pellazgët?

Që të rikthehem tek kërkimi ynë, helenët që ruajtën kaq gjëra nga pellazgët, nuk do të ruanin më të rëndësishmen: një përlleshje gjigande me pellazgët?

Nga ana tjeter, ata që konsiderojnë helenët autoktonë dhe ndërrohë veçojnë prej tyre pellazgët, bien në një antitezë të fortë me legjendat e lashta sipas të cilave banorë të parë të këtij vendi janë pellazgët!

Problemi, për kërkuesit me vullnet të mirë, është se pellazgët nuk përmenden si krijues të një qytetërimi të madh e nëse pellazgët konsiderohen grekë, atëherë në përputhje me të gjitha dokumentat e tjera, të vjetra e të reja, grekët e shqiptarët përbëjnë një fis.

Dhe këtë qëllimet e sotme nuk e lejojnë.

Por le të kujtojmë se fisi helen nuk ishte gjithnjë, fisi i civilizuar fisi Mikenës dhe i Athinës, por një fis barbar që me kalimin e kohës u zhvillua. Nëse këtë nuk e kuptoi Herodoti, do të thotë se kishte një pamjaftueshmëri të falshme nga ana shkencore.

## ETIMOLOGJIA E EMRIT KOMBËTAR “PELLAZG”

Do të përmend versionet kryesore për prejardhjen e emrit kombëtar “Pellazg”.

Sipas një varianti, fjala “Pellazg”, vjen nga fjala “Plasin” dhe “Pelago”, sepse siç pohon, pellazgët erdhën nga Pelagu. Fillimisht askund nuk thuhet se erdhën nga Pelagu, por dhe po të ish kështu, do ntë quheshin pelagë dhe jo pellazgë.

Mitropoliti bizantin Evstathio, quan banorët e Azisë së Vogël si pellazgë. E nxjerr emrin e tyre nga Pelas Jis, që do të thotë “Tokë e afërt” dhe si të tillë mendon Azinë e Vogël. Por dhe sikur ky version të ishte i saktë, përsë Evstathio sheh si tokë të afërt Azinë e Vogël dhe jo Italinë ose akoma më pranë, Ilirinë?

Gjeografi i madh i lashtësisë, Stravoni, nxjerr fjalën “Pellazg” nga “pelarg”, por që eshte emri i dytë i tyre që u kanë dhënë helenët dhe më saktë athinejtë.

Që Myleri e nxjerr prejardhjen nga fjala “Pelin” dhe “Argo” ku fjala “argo” është pellazge dhe do të thotë fushë, ndërsa i gjithë togfjalëshi ka kuptimin e atij që jeton nëpër fusha.

Homeri e quan Tesalinë “argo pellazg”, që do të thotë fushë pellazge. Në Greqi ekziston fusha (Argo) e Thesprotisë e Peloponezit, etj. etj. Shqipja e ruan rrënjën e fjalës argo (ar-) dhe e përdor si “arë” që do të thotë fushë e mbjellur.

Profesor Saqelariu e gjykon etimologjinë e fjalës nga rrënjet indoevropiane Bhel=cel dhe Osqho=degë, bisk. Është një version që u formua më, 1958-ën dhe me ndryshime a me modifikime të gërmave nxjerr përfundimin se pellazg do të thotë “degë e çelur”. Sigurisht që nuk ka se ku të mbështetet, por autor i arsyeton mefaktin se pellazgët lidhen me përhapjen e ushqimit në Tokë. Por unë nuk shoh ndonjë lidhje të degës së çelur me pellazgët dhe të kësaj veçorie të tyre e cila është një nga të shumtata dhe së fundi nuk përmendet diku, por del në bazë konkluzionesh. Pastaj, vetitë kryesore te pellazgëve janë heroizmi dhe braktisja e fushave që ata shfrytëzonin për të siguruar ushqimin.

Kush, pra, është versioni më i saktë etimologjik?

Personalisht mendoj se mendimi i Stravon-Myler është më i saktë, sepse mbulon si nga ana gjuhësore ashtu dhe nga ana kuptimore fjalën “Pellazg”. Dmth. Stravoni dhe Myleri kanë të njëjtën ide me atë të athinejve të lashtë. E nxjerrin prejardhjen e pellazgut nga “pelargu”, që do të thotë lejlek në shqip (shën. i përkth.). Fjala pelarg del nga “Pelin” dhe “argo”, siç pamë më lart dhe me të vërtetë lejlekut i pëlqejnë zonat fushore.

Lejleku ka dhe ngjajshmëri të tjera me pellazgët. Jeton në toka fushore dhe moçalore. Pellazgët kanë të bëjnë me ndërtimin e veprave të mëdha kanalizuese dhe për ujitjen e zonave të mëdha si ajo e Kopadies.

Një veçori tjetër e ngjashme midis pellazgëve dhe lejlekëve është emigrimi. Aristofani në një komedi të tij thotë se pellazgët emigrojnë ashtu si lejlekët.

Një tjetër veti është dhe mbrojtja deri në sakrificë e prindërve të tyre. Aristoteli na tregon (historia e kafshëve 2,9,13.) se lejlekët e rinj i marrin më të moshuarit në shpatulla me qëllim që të emigrojnë. Kjo dashuri, detyrim madje dhe respekt i dekretuar ndaj prindërve të tyre është dhe një nga elementët bazë të ideologjisë së helenëve të lashtë. E theksoj se në Greqi dashuria dhe respekti për prindërit ishte i caktuar me ligje të cilat quhen “Ligjet e Lejlekut” (Ligjet Pelarge). Pra ekzistojnë shumë fakte mbi etimologjinë e fjalës pellazg nga fjälët “pelin” dhe “argo” nga të cilat formohet pelargu. Fakti që helenët i quanin pellazgët, pelarge e vërteton këtë version.